



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Kimi”

i

**Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Ismail Qemali”
Vlorë.**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Adelaida Andoni

2. Prof. Dr. Kledi Xhaxhiu

Qershor/2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Kimi”

| | | |
|-----|---|---|
| Nr. | | |
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Kimisë |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Bachelor në “Kimi” |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 124, datë 17.2.2010 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | UMASR Nr. 439, datë 09.09.2011 |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i parë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 3 vite |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 180 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Kohë e plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 6 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: (Viti akademik 19-20) | 8 PAE/1 PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | 21 studentë <i>Shënim: 2 vitet e fundit nuk ka patur studentë të regjistruar</i> |
| 19 | Komente / të tjera: | - |

Përshkrim përmbledhës

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë e ushtron aktivitetin e tij mësimor-kërkimor bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Statutin e Universitetit, Rregulloren bazë të tij, Strategjinë e tij dhe në aktet e tjera rregullatore të institucionit. Programi i studimit Bachelor në “Kimi” i ciklit të parë ofrohet nga Departamenti i Kimisë dhe është pjesë e njësitë bazë të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore, të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë. Departamenti i Kimisë është hapur në vitin akademik 2010-2011, me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 124 datë 17.02. 2010. Në vitin 2013 është diplomuar brezi i parë i studentëve. Deri më tani Departamenti i Kimisë ka diplomuar 8 (tetë) breza studentësh. Programi i studimit Bachelor në “Kimi” ofron përgatitjen, formimin dhe diplomimin e studentëve në fushën e kimisë në përputhje me tregun e punës. Ky program ofrohet me kohë të plotë dhe është organizuar duke respektuar legjislacionin në fuqi lidhur me organizimin e programeve të studimit (VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018). Programi i ciklit të parë, Bachelor në “Kimi” i përket nivelit 6 (gjashtë) të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi është organizuar në 6 (gjashtë) semestra akademike me nga 30 kredite (ECTS) secila. Programi i ciklit të parë Bachelor në “Kimi” zhvillohet me kohë të plotë në 3 (tre) vite akademike në gjuhën shqipe. Lëndët e programit janë të ndara në lëndë bazë, lëndë karakterizuese, dhe lëndë ndërdisiplinore/integruese, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse sipas Udhëzimit të MASR Nr.41, dt. 24. 01. 2018. Aktualisht, Departamenti i Kimisë ka në përbërjen e tij personel akademik prej 7 (shtatë) pedagogësh me kohë të plotë, nga të cilët, 1(një) Profesor i Asociuar, 4 (katër) Doktor Shkencash, 1 (një) Doktor në proces dhe 1 (një) Master Shkencor.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Përbërja e GVJ: Bordi i Akteditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën **Prof.Dr. Adelaida Andoni** dhe **Prof. Dr. Kledi Xhaxhiu** si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga koordinatori teknik i ASCAL **Znj. Aviola Bardhi**.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u kontraktua nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) për të bërë vlerësimin e jashtëm të programit të studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Kimi” ofruar nga Departamenti Kimisë, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore (FSHT), Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë (UV). Qëllimi i këtij raporti është të japë një vlerësim të pavarur për shkallën në të cilën Departamenti i Kimisë (FSHT/UV) është i përgatitur dhe i angazhuar për të përmbushur standardet akademike të diplomave që lëshon. Për të arritur në këtë vlerësim, GVJ u mbështet në shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, në dokumentacionin bazë mbi të cilin bazohet veprimtaria e IAL (statuti, rregullorja, strategjia etj.), dosjen e programit të studimit, dokumentacionin e sekretarisë mësimore, takimet dhe vizitat “online” të organizuara në institucion etj.

Më datë 28.05.2021, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare 1/55 prot, datë 28.05.2021 dërgohet në Institucion Draft- Raporti i vlerësimit të jashtëm. IAL përcolli komentet përmes AMS më datë 07.06.2021 dhe me shkresë zyrtare Nr. 920/5 Prot, datë 04.06.2021.

GVJ pasi u njohën me komentet e institucionit mbi Draft- Raportin sqaron si vijon:

Në përgjigje të komentit të standardit I.3, kriteret 2 dhe 3, GVJ thekson se nuk ka evidenca mbështetëse në RVB për studimin e tregut të punës. Link-u i raportuar në përgjigjen e GVB përfshin vetëm pyetësoarin. **GVJ konkludon se vlerësimi për standardin I.3, kriteret 2 dhe 3 mbetet i pandryshuar.**

(<https://docs.google.com/forms/d/1WOna7amzitpxhouUSWhmaJQuGvezK2914Mt94YIJZ5Y/edit?ts=5e3969a2#responses>)

Në vijim të komenteve të standardit I.4, kriteri 1, GVJ argumenton edhe pse numri i studentëve në programin e studimit është i vogël, në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies është e nevojshme dhe e mundur rritja e numrit të personelit akademik të kualifikuar (kategoria “Profesor”). **Vlerësimi ynë për standardin I.4, kriteri 1 i mbetet i pandryshuar.**

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 4

Përsa më sipër, në lidhje me komentet e standardit II.2, kriteret 1 dhe 4, GVJ ri-thekson megjithëse detyrimi ligjor në lidhje me gradat dhe titujt përmbushet, rritja e cilësisë së mësimdhënies është një domosdoshmëri e cila mund të përmbushet nëpërmjet rritjes së numrit PAE të kualifikuar. Në përgjigjen e dt. 04.06.2021 GVB argumenton se në DK japin mësim presonel akademik i kategorisë Profesor në lëndët Matematikë, Fizikë, Biokimi, Gjuhë e Huaj dhe Informatikë.

GVJ i qëndron vlerësimit të dhënë në RVJ (standardit II.2, kriteret 1 dhe 4) dhe thekson se është e nevojshme kualifikimi dhe rritja e numrit të stafit PAE jo vetëm për lëndët e sipërpërmenduar por edhe të lëndëve të profilit “Kimi” siç janë ato të gruplëndëve “Kimi Fizike”, “Kimi Analitike”, “Kimi Organike” dhe “Kimi e Përgjithshme dhe Inorganike”.

Në përgjigje të komentit të standardit II.3, kriteri 6, edhe pse syllabuset e lëndëve përfshijnë disa elementë, përpilimi dhe nënshkrimi i tyre nga titullari i kategorisë “Profesor” lidhet jo vetëm me përmbushjen e kuadrit ligjor por edhe me nevojën e rritjes së cilësisë të përmbajtjes së syllabuseve (temat e leksioneve, seminareve dhe laboratoreve etj).

Gjithashtu, në përgjigje të standardit II.4, kriteri 3, vlerësojmë se ri-shpërndarja e krediteve për të krijuar lëndë të reja mëse të nevojshme për programin e studimit bachelor në “Kimi” lidhet ngushtë me arritjen e objektivave formuese dhe rezultatet e të nxënit. **Vlerësimi ynë për standardin II.4, kriteri 3 mbetet i pandryshuar.**

Në vijim të komentit të standardit II.4, kriteri 6, ri-theksojmë se pjesa e literaturës shqipe është huazuar kryesisht nga FSHN/UT. Nevoja për të përmisuar/përditësuar syllabuset nëpërmjet përmisimit të ciklit të leksioneve në shqip kërkon staf akademik të kualifikuar. **GVJ i qëndron vlerësimit të dhënë në RVJ.**

Në përgjigje të standardit II.4, kriteret 8 dhe 9, GVJ argumenton se nuk ka evidencë mbështetëse në RVB për studimin e tregut të punës. Mbështetur në përvojën tonë edhe pse numri i studentëve në Departamentin e Kimisë të FSHTN/UV është i vogël GVJ mendon se është e mundur realizimi i workshop-ve në nivel departamenti ose fakulteti. **Vlerësimi ynë për standardin II.4, kriteret 8 dhe 9 mbetet i pandryshuar.**

Në lidhje me komentin e GVB referuar standardit II.5, kritereve 1 dhe 2, GVJ i referohet komenteve të dhëna në Standardin II.2, kriteret 1 dhe 4 dhe Standardit I.4, Kriteri 1. **Vlerësimi ynë për standardin II.5, kriteret 1 dhe 2 mbetet i pandryshuar.**

Në përgjigje të komentit të standardi III.1 kriteret 3 dhe 4, GVJ vlerëson se është ngritur Njësia e Sigurimit të Cilësisë në nivel universiteti, gjithsesi ngritja e një njësie të tillë edhe në nivel Fakulteti është e rekomandueshme. Njësia në nivel Fakulteti monitoron dhe vlerëson programet në bashkëpunim me departamentet. **Vlerësimi ynë për standardin III.1, kriteret 3 dhe 4 mbetet i pandryshuar.**

Komenteve të GVB për standardin III.2, kriteri 4, GVJ i referohet vlerësimeve të dhëna tek Standardi II.2, kriteret 1 dhe 4 dhe Standardit I.4, kriteri 1. **Vlerësimi ynë për standardin III.2, kriteri 4 mbetet i pandryshuar.**

Në vijim të komentit të dhënë nga GVB për standardin III.4, kriteri 1, theksojmë se DK ka një aktivitet mësimor-kërkimor 10 (dhjetë) vjeçar dhe në vlerësimin tonë gjykojmë se është e mundur realizimi i pyetësorëve dhe analizave përkatëse për periudha disa vjeçare. GVJ i referohet periudhës para dorëzimit të raportit. **Vlerësimi ynë për standardin III.4, kriteri 1, mbetet i pandryshuar.**

Referuar standardit IV.5, kriteri 6, GVB komenton se faqja zyrtare e UV ofrohet edhe në gjuhën angleze (<https://univlora.edu.al/en/>). GVJ e tërheq rekomandimin e dhënë tek standardit IV.5, kriteri 6 për ofrimin e faqes zyrtare edhe në gjuhën angleze. Gjithsesi rekomandimi ynë nuk e prekte shkallën e përmbushjes të standardit (përmbushet plotësisht).

Në përgjigje të komentit të dhënë tek standardi V.3, kriteri 3, GVJ i referohet vlerësimin të standardit I.3, kriteret 2 dhe 3. **Vlerësimi ynë për standardin V.3, kriteri 3, mbetet i pandryshuar.**

Referuar komentit të standardit VI.1, kriteri 1, GVJ vlerëson se DK/UV ka ndërmarrë të gjitha hapat për të siguruar strukturat dhe procedurat e nevojshme për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Gjithsesi GVJ thekson se në RVB duhet të kishte evidenca të pyetësorëve dhe analizave përkatëse jo vetëm për 2 (vite) akademike dhe 1 (një) vit akademik respektivisht. GVJ i referohet periudhës para dorëzimit të raportit. **Vlerësimi ynë për standardin VI.1, kriteri 1, mbetet i pandryshuar.**

Gjirhashtu referuar komentit të GVB për standardin VI.2, kriteri 2, GVJ i referohet komentit të standardit VI.1, kriteri 1.

Në vijim të komentit të standardit VI.2, kriteri 3, GVJ vlerëson se kontrolli nga ana e Përgjegjësit të Departamentit (përfshirë këtu dëgjimi i një ore leksioni apo seminari) mund të

evidentohet nëpërmjet mbajtjes së një procesverbali dhe ky i fundit mund të ruhet në departament.


Në lidhje me komentin e standardit VI.2, kriteri 5, GVJ i referohet komentit të dhënë tek standardi VI.1, kriteri 1.

Përsa më sipër, vlerësimi ynë në lidhje me kriteret 1, 2, 3 dhe 5 të standardit VI.2 mbetet i pandryshuar.

Së fundi, në lidhje me komentet e standardit VI.5, kriteret 2 dhe 3, GVJ i tërheq konstatimet “Vërehet se link-u i raportit të analizës së pyetësorëve¹ rezulton joaktiv” dhe “Evidenca VI.1: Vendimi i Senatit, Nr. 21, datë 08.05.2018, e shoqëruar me link-un përkatës, nuk është aktive ne faqen zyrtare të UV”. GVB ka përfshirë në komentet e tij link-et e sakta. Gjithashtu në përgjigje të komenteve të kriterëve 2 dhe 3, GVJ i referohet komenteve të dhëna tek standardi VI.1, kriteri 1.

Përsa më sipër, vlerësimi ynë në lidhje me kriteret 2 dhe 3 të standardit VI.5 mbetet i pandryshuar.

¹<https://univlora.edu.al/2019/12/11/publikimi-i-raportit-te-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve/>



Vlerësimi I Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Kimi”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

| Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare. | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve | | | |
| Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë (statuti i UV dhe Plani Strategjik 2018-2024 i UV, evidencat A dhe B), Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore të Universitetit të Vlorës, nga RVB dhe takimet “online” me stafin pedagogjik dhe me studentët rezultojnë se programi i studimit Cikli i Parë (Bachelor në “Kimi”) nuk bie ndesh me interesat kombëtare. | | | |
| Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Bazuar në pikat e përmendura në Kriterin 1 si dhe evidencat mbështetëse (evidencat A dhe B), vihet re se Departamenti i Kimisë, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore të Universitetit të Vlorës, në programin e studimit Cikli i Parë (Bachelor në “Kimi”) synon promovimin dhe përhapjen e njohurive shkencore nëpërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në shërbim të zhvillimit rajonal. Si i tillë synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore rajonale dhe kombëtare. | | | |
| Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Bazuar në Statutin e UV dhe në Rregulloren e Departamentit të Kimisë (evidenca I.2) programi i studimit cikli i parë (Bachelor në “Kimi”) ofrohet me synim përgatitjen dhe formimin e kimistëve të aftë për tregun e punës, në kuadër të zhvillimit rajonal dhe kombëtar. Si i tillë, programi i përmbush kërkuesat e kriterit 3. | | | |
| Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. | Bazuar në Planin Strategjik të UV 2018/2024 dhe Planin Strategjik të Departamentit të Kimisë (evidenca I.3) vihet re se programi i studimit Cikli i Parë (Bachelor në “Kimi”) ofrohet duke konsideruar kërkuesat e punës në shkallë rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Nëpërmjet tij synohen të përgatiten studentë me njohuritë përkatëse të vlefshme për fushat: e arsimit, industrinë kimike, ushqimore, ambientale dhe farmaceutike, nëpërmjet të cilëve pritet nxitje e zhvillimit ekonomik lokal edhe më gjerë. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|-----------------|-------------------------------|
|-----------------|-------------------------------|

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit. | Bazuar në Planin Strategjik të UV 2018/2024, në Strategjinë e Zhvillimit Afatmesëm dhe Afatgjatë të Departamentit të Kimisë (evidenca I.4), si edhe në RVB vihet re se programi i studimit Cikli i Parë (Bachelor në “Kimi”) është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe zbatim të strategjisë për zhvillim të UV. | | | |
| Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit. | Nga Statuti i UV (evidenca A) (publikuar “online” në: https://univlor.edu.al/statuti/) dhe Rregullorja e këtij universiteti (evidenca C) (publikuar “online” në: https://univlor.edu.al/rregullorja/), përcaktohen qartë drejtimit prioritar akademike të UV. Bazuar në këto dokumenta, programi i studimit Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) është hartuar dhe ofrohet në përputhje me këto dokumenta. | | | |
| Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit. | Nga sa u përmend më sipër, në përmbushje të kriterit 2 (Standardi 1) konstatohet (evidenca I.5) se programi i studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) është emërtuar sipas fushës së studimit “Shkenca Natyrore”, është i organizuar në 3 (tre) vite akademike (6-gjashtë semestra) me nga 60 kredite/vit dhe strukturuar në bazë të nenit 56 të Statutit të UV, në të cilin theksohet se “Universiteti i Vlorës ofron diploma të ciklit të parë të studimeve”, si dhe neneve 36, 37 të rregullores së këtij universiteti. Këto dokumenta janë hartuar në përputhje me ligjin e arsimit të lartë (Ligji 80/2015). | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi I.3

Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV dhe RVB vihet re se programi i studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) ka objektiva të përcaktuar qartë në lidhje me kompetencat dhe njohuritë që fitojnë studentët (plani mësimor i Programit Bachelor në “Kimi”; https://univlor.edu.al/bachelor-kimi/). Objektivat e çdo lënde të programit të studimit (evidenca I.7), së bashku me njohuritë dhe kompetencat që fitojnë studentët prej tyre janë paraqitur në syllabuset përkatës. Ky program synon t'i pajisë studentët me njohuri të përgjithshme (lëndët bazë) dhe specifike/profesionale, duke i aftësuar ata për kualifikime të mëtejshme (Master Profesional/Shkencor) ose për tregun e punës vendas e të huaj. |
| Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV, RVB dhe diskutimin “online” me përfaqësuesit e Departamentit të Kimisë u konstatua se në lidhje me programin e |

ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.

studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”), FSHNT/DK nuk kanë kryer studime paraprake dhe periodike mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës.

GVJ vëren se link-u² (footnote 29 në RVB) i përdorur si pyetësor për studimin e tregut të punës nuk ka asnjë evidencë mbështetëse që të pasqyrojë rezultatet e plota të pyetësorit (“database” i të dhënave, emrat e studentëve që kanë marrë pjesë në pyetësor, lista e emrave etj).

GVJ vlerëson se Tabela 23 (referuar RVB) nuk është e mjaftueshme!

Megjithatë rezultojnë të dhëna nga vetë Departamenti i Kimisë (në RVB) se studentët e diplomuar aty janë punësuar në sektorët publikë (35 % e rasteve) dhe privat (40 % e rasteve). Ndërkohë anketimet e kryera nga institucioni mbi përputhshmërinë e diplomës në lidhje me tregun e punës (punësimin e studentëve të diplomuar) rezultojnë: 60% pozitive dhe 40 % negative.

Rekomandohet që Departamenti i Kimisë në koordinim me Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore të kryejë studime periodike mbi tregun e punës për programin që ofron. Gjithashtu rekomandohet që institucioni të mbajë lidhje të vazhdueshme me studentët të cilët kanë përfunduar studimet në Ciklin e Parë (Bachelor në “Kimi”), në formën e organizimeve Alumni, për të ndjekur ecurinë e tyre pas studimeve, duke mundësuar në këtë mënyrë përshtatjen sa më të mirë të programit të studimit me kërkesat e tregut dhe rritjen e mundësisë së punësimin e studentëve vijues.

Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.

Sikurse përshkruhet edhe në syllabuset e lëndëve (evidenca I.7, Tabelat 10 dhe 11 në RVB) përbërëse të programit të studimit në Ciklin e Parë (Bachelor në “Kimi”), ky program ka objektiva të qarta formues në disiplinat që përmban. Gjithashtu bazuar në përmbajtjen e syllabuseve të këtij programi garantohet përfitimi i dijeve, aftësive dhe kompetencave në drejtimet në të cilat ato fokusohen. Nga RVB dhe diskutimi “online” me përfaqësuesit e Departamentit të Kimisë u vu re se puna e stafit akademik të Departamentit të Kimisë ishte e fokusuar në formimin e studentëve në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Megjithatë, në mungesë të studimeve afatshkurtra dhe afatgjata të nevojave të tregut lokal dhe ndërkombëtar të punës nga ana e institucionit, aktualisht duket e vështirë përshtatshmëria e programit të studimit Bachelor në “Kimi” në lidhje me to.

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

²<https://docs.google.com/forms/d/1WOna7amzitpxhouUSWhmaJQuGvezK2914Mt94YIJZ5Y/edit?ts=5e3969a2>
Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë E-mail: info@ascal.al

Standardi I.4**Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV, RVB (evidenca I.9) konstatohet se FSHTN, UV përbëhet nga 7 (shtatë) departamente, ku secili ka të paktën 7 (shtatë) anëtarë si personel akademik me kohë të plotë. Përsa i përket Departamentit të Kimisë, ai ka 7 (shtatë) anëtarë si personel akademik me kohë të plotë, nga të cilët 1 (një) ka titullin “Profesor i Asociuar”, 4 (katër) kanë gradën shkencore “Doktor i Shkencave”, 1 (një) është në process kualifikimi për gradën shkencore “Doktor i Shkencave” dhe 1 (një) është me kualifikimin “Master i Shkencave”.</p> <p><i>Bazuar në ngarkesën e departamentit (lëndët dhe numrin e orëve të mësimdhënies) rezultoi se një pjesë e tyre plotësohet nga pedagogë të jashtëm, me titullin “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”. Gjithashtu vihet re se ngarkesa efektive për pedagog është e lartë (numri i lëndëve/orëve) krahasuar me kolegët e tyre në universitete të tjera. Rekomandohet që për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies nga studentët të rritet jo vetëm numri i personelit akademik por edhe kualifikimi i tyre (referuar tabelës 4 në RVB).</i></p> <p><i>Nga diskutimi “online” me anëtarë të Departamentit të Kimisë u vu re se ky departament i plotëson kushtet e mësimdhënies përsa i përket hapësirave fizike për auditorë, laboratore, bibliotekë, zyra dhe raportit student-sipërfaqe (Tabela 16, RVB). Nga ana tjetër, u vu re se përtej përpjekjeve të departamentit për të siguruar bazë materiale për zhvillimin e punëve laboratorike, veçanërisht ato të Kimisë Fizike dhe Koloidale, ajo ishte e pjesshme ose mungonte. Për zhvillimin e plotë të laboratorëve, të cilët një kontribut të konsiderueshëm në formimin teoriko-praktik të studentëve rekomandohet pajisja e këtyre laboratorëve.</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV, RVB konstatohet se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) është në përputhje me fushën akademike-kërkimore të FSHT, UV, i bazohet në manualin e Frascati-it (https://en.wikipedia.org/wiki/Frascati_Manual) mbi klasifikimin e fushave të shkencës (FOS). Bazuar në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, ky program i ofruar nga Departamenti i Kimisë është i nivelit 6 (gjashtë) dhe është në përputhje me të gjitha dizpozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi (LAL dhe Statuti i UV-evidenca A).</p> |
| <p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e</p> | <p>Përsa i përket kodifikimit, programi i Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) është ndërtuar në ngjashmëri me programet analoge të universiteteve të tjera, konkretisht Fakulteti i Shkencave të Natyrës</p> |

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 11

| | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|
| programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | (FSHN), Universiteti i Tiranës (UT), etj. duke plotësuar kushtin e ngjashmërisë deri në nivelin 70 %. Kjo ngjashmëri e programeve studimore ndëruniversitare bën të mundur transferimin e studimeve (evidenca I.13) dhe njohjet reciproke të lëndëve të kryera apo krediteve të fituara. | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht |
| | | | X |

| Standardi I.5 | |
|---|--|
| Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV dhe RVB konstatohet se marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda UV për mbarëvajtjen e programeve të studimit, rregullohen nëpërmjet dy dokumentave rregullues bazë, Statutit (evidenca A) dhe Rregullores së UV. Veprimtaria e UV organizohet dhe realizohet nga njësitë akademike, ndihmës-akademike dhe administrative, në strukturën e rektoratit, sipas shpjegimit vijues: Organizimi në bazë fakulteti bëhet nga dekanati i çdo fakulteti, i cili miraton hapjen dhe organizimin e programeve të studimit, kuotat dhe kriteret e pranimit të studentëve në programet e studimit, etj. Dekanati bashkërendon punën me Senatin Akademik të UV për çështjet e sipërpërmendura. Departamentet, nëpërmjet drejtuesëve të tyre bashkërendojnë punën me dekanatin përkatës. Bashkërendimi i punës ndërmjet dekanatit dhe studentëve realizohet nga këshilltari akademik (evidenca I.18) për studentët, i caktuar çdo vit prej Drejtuesit të Departamentit. Strukturat ndihmës-akademike me karakter administrative janë në varësi të Administratorit të UV-së (evidenca A). Çdo fakultet analizon dhe pasqyron çdo vit rezultatet e veprimtarisë së tij dhe departamenteve në varësi. |
| Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV dhe RVB konstatohet se për të realizuar objektivat e procesit mësimor e formues të studentëve, UV ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me shumë institucione homologe. Konkretisht për realizimin e Programit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”), ky institucion ka realizuar marrëveshje me universitete të rajonit dhe më gjerë në kuadër të programeve të bashkëpunimit “Erasmus” (evidencat I.29 dhe I.30) dhe “Mevlana”. UV (evidenca I.30) është anëtarësuar në disa rrjete bashkëpunimi në fushën e arsimit të lartë. |
| Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV dhe RVB konstatohet se Departamenti i Kimisë mban në mënyrë periodike takime me personelin akademik ku vlerësohen |

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 12

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve. | mobilitetet e personelit akademik dalës dhe hyrës në kuadër të shkëmbimit të përvojave në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, si dhe nxiten mobilitete të reja. Në lidhje me kërkesat e Kriterit 3 (Standardi I.5) vihet re DK ka hartuar raporte analitike të shkruara (evidenca I.35) në lidhje me përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”). | | | |
| Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV dhe RVB konstatohet se UV ka vendosur marrëdhënie zyrtare bashkëpunimi me disa institucione shtetërore dhe private për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale të studentëve (evidenca I.36). Meqënëse programi i Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) nuk e përman në kurikulën e tij praktikën profesionale të studentëve, atëherë Departamenti i Kimisë nuk e ka të nevojshme bashkëpunimin me punëdhënësit për kryerjen e praktikës profesionale. | | | |
| Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV dhe RVB konstatohet se UV ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët në bashkërendim me Qendrën e Zhvillimit Rajonal (RDC) (evidenca I.28). Kjo qendër identifikon dhe analizon nevojat për edukim të vazhdueshëm, si edhe organizon programe të shkurtra trajnimi për studentët dhe stafin. Krahas trajnimeve, FSHT (UV) dhe Departamenti i Kimisë organiojnë seminare, workshop-e, leksione të hapura, simpoziume e konferenca ndërkombëtare. Meqënëse pjesa më e madhe e studentëve të diplomuar në Ciklin e Parë (Bachelor në “Kimi”) synojnë kualifikimin e mëtjshëm në të njëjtin profil, brenda apo jashtë vendit, këtë aktivitete të organizuara janë të një ndihmese të veçantë për ta. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

| Standardi II.1 | |
|--|--|
| Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> | <p>Programi i studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) është hartuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si Ligji i Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, VKM Nr. 41 dt. 24.01.2018 dhe Udhëzimi Nr. 15 dt. 04.04.2008.</p> <p>Bazuar në RVB dhe në takimet “online” me përgjegjësën dhe stafin e Departamentit të Kimisë u vu re se programi i studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) është i organizuar në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) (evidenca I.6). Plani mësimor realizohet në 3 (tre) vite studimi (6-gjashtë, semestra), me një numër total kreditesh 180. Në planin mësimor të vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë renditen lëndët mësimore (të klasifikuara sipas kategorive A, B, C, D, E, F), kreditet për secilën lëndë dhe detyrimet që ka studenti për to (referuar planit mësimor Tabela 11 në RVB, evidenca I.6).</p> |
| <p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p> | <p>Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV vihet re se programi i studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) i ofruar nga Departamenti i Kimisë përmban lëndë bazë të kimisë të cilat i mundësojnë studentëve njohuri të përgjithshme teorike dhe praktike në fushën e kimisë (evidenca I.6). Me këto njohuri studentët janë të aftë për të punuar në një shumëllojshmëri profesionesh e specialitetesh, qofshin këto në sektorin publik apo privat.</p> |
| <p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p> | <p>Në vijim të kriterit 2, të përmendur më sipër programi i studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) ofron njohuri të përparuara, duke përshtatur jo vetëm materiale bashkë-kohore mësimdhënëse por duke përdorur edhe metodika të reja mësimdhënëse. Disa nga lëndët e avancuara të programit të gërshetuara me punët praktike (detyra kursi, laboratore dhe punime diplome) u mundësojnë studentëve thellimin në mendimin kritik shkencor dhe kuptimin e drejtë të parimeve akademike në fushën e kimisë (evidencat I.6 dhe I.7).</p> |
| <p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p> | <p>Programi i studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) në sajë të larmishmërisë së lëndëve që ofron (evidencat I.6 dhe I.7) dhe metodave të mësimdhënies mundëson një mësimnxënie efektive dhe kompetenca të avancuar në fushën e kimisë.</p> <p>Me njohuritë e fituara teorike dhe eksperimentale/praktike (evidencat I.6 dhe I.7) studentët aftësohen në zgjidhjen në mënyrë të pavarur detyra kursi, punë laboratorike apo punime diplomash në të cilat shpesh studentët ballafaqohen me zgjidhje problemesh komplekse dhe të</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | paparashikuara, duke i aftësuar ata që të jenë të pavarur në zgjidhjen e problemeve konkrete në fushën e kimisë. | | | |
| Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV dhe RVB vihet re se programi i studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) përmban të gjithë elementët strukturorë në përputhje me aktet ligjore e nën ligjore fuqi (evidencat I.6, I.7 dhe II.1). | | | |
| Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV dhe RVB vihet re se programi i studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) i ka të grupuara lëndët sipas kategorive të përcaktuara, me ngarkesën përkatëse dhe përqindjen e krediteve të përcaktuara (evidencat I.6, I.7 dhe II.1) nga Udhëzimi Nr. 15 i MASR, dt. 04.04.2008. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV dhe RVB vihet re se programi i studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) është hapur sipas VKM Nr. 124, dt. 17.02.2010. Plani mësimor i këtij programi i është nënshtruar vlerësimit periodik nga Senati Akademik i UV dhe ka marrë vlerësimin përfundimtar. Në dt. 21.09.2017 Bordi i Akreditimit të ASKAL i ka dhënë vlerësimin institucional me Vendimin Nr. 71 (evidenca II.6). <i>Departamenti i Kimisë së UV ka 7 (shtatë) pedagogë (referuar Tabelës 1.1 në RVB) me kohë të plotë si staf akademik me grada dhe tituj, por për të rritur nivelin e profesionalizmit në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor rekomandohet që në përbërje të këtij stafi të rritet numri i pedagogëve me kohë të plotë me titujt “Prof. Dr.” dhe “Prof. Asoc. Dr.”.</i> |
| Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinitorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV, RVB dhe diskutimin “online” me përfaqësuesit e Departamentit të Kimisë u konstatua se Përgjegjësi i Departamentit është koordinatori dhe monitoruesi i programeve të studimit që ofron Departamenti i Kimisë (evidencat I.2 dhe II.7). Ndërkohë që, detyrat e koordinitorit të programit akademik i mbulonte koordinatori për marrëdhëniet me studentët. Përgjegjësia e koordinitorit të programit ishte ecuria dhe zhvillimi i programit. |
| Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV, RVB dhe diskutimin “online” me përfaqësuesit e |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | Departamentit të Kimisë u konstatua se ai i përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin e strukturës akademike (evidenca II.7). | | | |
| Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV, RVB dhe diskutimin “online” me përfaqësuesit e Departamentit të Kimisë u konstatua se <i>numri i personelit (stafit akademik) i brendshëm është i pakët në numër dhe në këtë mënyrë ngarkesa pedagogjiko-shkencore mbi çdo anëtar të stafit është relativisht e lartë. Për të shpërndarë këtë ngarkesë, Departamenti i Kimisë fton pedagogë me kohë të pjesshme nga universitete të tjera të vendit tonë (referuar Tabelave 2, 4 dhe 6 në RVB).</i> <i>Gjithashtu u vu re se nga stafi i brendshëm vetëm një pedagog rezultonte me titullin akademik “Prof. Asoc. Dr.”, ndërkohë që pjesa tjetër ishte me gradën shkencore “Dr.” (4), “Dr.” – në proces (1) dhe Msc. (1) (referuar tabela ve 2 dhe 6 në RVB). Pavarësisht se kriteri ligjor përmbushet (departamenti ka të paktën 7-shtatë PAE nga të cilët të paktën 3 (tre) janë me grada/tituj), për të rritur cilësinë e mësimdhënies, rekomandohet që të rritet numri i personelit akademik me tituj akademikë.</i> | | | |
| Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV, RVB dhe diskutimin “online” me përfaqësuesit e Departamentit të Kimisë u vu re se Departamenti i Kimisë, përgjegjës për programin e studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) është organizuar dhe strukturuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi, në lidhje me mësimdhënien, fushën e kërkimit, gjuhën e studimit, transferimin e studimeve, njohjen dhe njehsimin e periudhave të studimit, kohëzgjatjen e studimeve, lëshimin e diplomës dhe shtimit të diplomës (evidencat I.13 dhe II.1). | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV, RVB dhe diskutimin “online” me përfaqësuesit e Departamentit të Kimisë u vu re se Departamenti i Kimisë, përgjegjës për programin e studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) disponon informacionet e nevojshme (akte ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe të gjithë elementët që kërkohen) për organizimin dhe strukturën e programit (evidencat I.2 dhe II.1). |
| Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë | |

| | |
|--|---|
| <p>e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> | <p>Programi i studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) është hartuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si Ligji i Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, VKM Nr. 41 dt. 24.01.2018 dhe Udhëzimi Nr. 15 dt. 04.04.2008. Bazuar në RVB dhe në takimet online me përgjegjësin dhe stafin e Departamentit të Kimisë u vu re se programi i studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) është i organizuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> |
| <p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p> | <p>Programi i studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) realizohet në 3 (tre) vite studimi (6-gjashtë semestra), me një numër total kreditesh 180, të cilat janë në përputhje dhe ekuivalente me Sistemin Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Në planin mësimor të vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë renditen lëndët mësimore (të klasifikuara sipas kategorive A, B, C, D, E, F), kreditet për secilën lëndë dhe detyrimet që ka studenti për to (evidencat I.6 dhe II.3).</p> |
| <p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV, RVB dhe diskutimin online me përfaqësuesit e Departamentit të Kimisë u vu re se Departamenti i Kimisë, përgjegjës për programin e studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) ka hartuar hartuar planin mësimor ku përcaktohet ngarkesa mësimore në auditor dhe jashtë tij. Për çdo lëndë të programit ekzistonin syllabuset përkatëse, të cilat përcaktojnë qartë frekuentimin/ndjekjen e programit nga studentët dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve të fituara (evidencat I.5, I.6, I.7 dhe II.3).</p> |
| <p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV (dosja e plotë e programit të studimit Bachelor në “Kimi”), RVB konstatohet se studentët pranohen në programin e studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) në bazë të Rregullores së Departamentit dhe Rregullores së Programit të Studimit. Studentët njihen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, ripranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve nëpërmjet programi të studimit (evidencat I.17, I.13, II.1).</p> |
| <p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV, RVB dhe diskutimin online me përfaqësuesit e Departamentit të Kimisë u vu re se Programi i Studimit Bachelor në “Kimi” është ngritur në përputhje me kuadrin përkatës ligjor, VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018. Secila lëndë e këtij programi ka syllabusin përkatës, në përputhje me formatin e miratuar, që përmban informacion të detajuar mbi titullarin e lëndës, ngarkesën (leksione, seminare, laboratore, praktika, orët prekatëse dhe kreditet), tipologjinë e lëndës, vitin dhe semestrin kur zhvillohet (evidencat I.5, I.6, I.7).</p> <p><i>Syllabuset përpilohen nga titullarët e lëndëve dhe duhet të nënshkruhen prej tyre. Bazuar në kuadrin aktual ligjor të arsimit të lartë, të drejtën për të nënshkruar një syllabus e ka titullari i lëndës në kategorinë e titullit akademik “Profesor”. Në këtë kategori rezultojnë vetëm një person si staf i brendshëm, që nuk mund të nënshkruajë çdo syllabus! Departamenti i Kimisë së UV ka në</i></p> |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>përbërje të tij staf me gradën shkencore “Dr”, “Dr”-ne proces dhe Msc. Në këto kushte, nënshkrimi i syllabuseve nga kjo pjesë e stafit për lëndët përkatëse nuk është në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor. Për këtë arsye, rekomandohet që Departamenti i Kimisë të rrisë numrin e personave të kualifikuar të kategorisë “Profesor”, të cilët të përmbushin këtë kërkesë të kuadrit ligjor në fuqi (referuar Tabelës 4 në RVB).</i> | | | |
| Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. | Bazuar në rregulloren e Departamentit të Kimisë të UV (evidenca I.2) parashikohet hartimi dhe përmirësimi i programeve të studimit. Bazuar në RVB dhe diskutimin online me pjesëtarë të Departamentit të Kimisë u evidentua fakti se çdo fillim vit akademik Departamenti i Kimisë miraton ndryshime të propozuara të programit akademik për vitin vijues. Këto ndryshime reflektohen në syllabuset e lëndëve dhe literaturën e miratuar. <i>Në kuadër të këtyre ndryshimeve, gjatë diskutimeve “online” me stafin e Departamentit të Kimisë, iu rekomandua shtimi i një lënde formuese, Kristalografia për Ciklin e Parë (Bachelor në “Kimi”). Referuar planit mësimor të programit (evidenca I.5) vërehet se kjo lëndë mungon.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

| | |
|--|--|
| Standardi II.4 | |
| Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV, RVB dhe diskutimin “online” me përfaqësuesit e Departamentit të Kimisë konstatohet se programi i studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) është strukturuar sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi. Konkretisht programi është strukturuar sipas Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL”, nenet 69, 70, 73; VKM 41. dt. 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. |
| Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV, RVB dhe diskutimin “online” me përfaqësuesit e Departamentit të Kimisë konstatohet se programi i studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) përmban lëndë karakterizuese dhe integruese të cilat janë emërtuar, strukturuar dhe zhvilluar për t’u mundësuar studentëve njohuritë dhe aftësitë e nevojshme si edhe punësimin. Lëndët janë shpërndarë në semestra dhe vite mësimorë të të ndarë në leksione dhe seminare si edhe të koordinuara me laboratorët përkatës, prej të |

| | |
|--|--|
| | <p>cilëve studentët fitojnë shprehitë e nevojshme eksperimentale, mjaft të nevojshme në aspektin profesional (evidenca I.5).</p> |
| <p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe aftësisimit profesional.</p> | <p>Ciklit i Parë (Bachelor në “Kimi”) përmban lëndë me karakter të përgjithshëm (në vitin e I-rë) (evidenca I.5 dhe I.7), të cilat synojnë t’i ofrojnë studentit informacion bazë dhe lëndë ndërdisiplinore dhe të specialitetit, të cilat trajtohen në vitin e II-të dhe të III-të. 3 vitet e studimit janë ndarë në semestra, ku çdo vit përfaqësohet nga semestri dimëror dhe ai veror. Bazuar mbi programin Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) dhe syllabuset e secilës lëndë konstatohet se orët mësimore (leksione, seminare dhe laboratore) me shpërndarjen e krediteve përkatëse mundësojnë arritjen e objektivave formuese.</p> <p>Megjithatë duke parë se shumica e lëndëve karakterizohet nga 8 (tetë) kredite (referuar Tabelave 10 dhe 11 në RVB), që përfaqëson një numër të lartë krahasuar me lëndët e njëjta/ngjashme në universitete të tjera, rekomandohet rritja e numrit të lëndëve që ofrohen dhe ulja e krediteve respektive për to.</p> |
| <p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV, RVB dhe diskutimin “online” me përfaqësuesit e Departamentit të Kimisë konstatohet se programi i studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) është i strukturuar në mënyrë të ngjashme jo vetëm me programet e të njëjtit profil brenda vendit por edhe me programe të ngjashme ndërkombëtare, në përputhje me sistemin Europian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ECTS). Ngarkesa semestrale është e ekuilibruar përsa i përket shpërndarjes së lëndëve dhe ngarkesa totale vjetore është 60 kredite, duke respektuar raportin teori/praktikë (evidenca I.5).</p> |
| <p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV, RVB konstatohet se programi i studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) duke qenë i strukturuar në mënyrë të ngjashme me programet e të njëjtit profil brenda dhe jashtë vendit (evidenca I.25), siguron një ndarje të drejtë të veprimtarive formuese (mësim në auditor; studim individual) dhe një raport efikas teori/praktikë.</p> <p>Pështatja e programit të studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) në sa u përshkrua më lart mundëson jo vetëm arritjen e objektivave formues të studentëve por edhe mundësinë e transferimit të studimeve në universitete të tjera brenda apo jashtë vendit. Me strukturën dhe ngjashmëritë me programet paralele të studimit të Ciklit i Parë (Bachelor në “Kimi”) në universitete të tjera, studentët jo vetëm që pajisen me formim të ngjashëm në këtë fushë por në këtë mënyrë atyre u mundësohet punësimi brenda (referuar Tabelës 23 në RVB) dhe jashtë vendit.</p> |
| <p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV, RVB dhe diskutimin “online” me përfaqësuesit e Departamentit të Kimisë u vu re se ekzistonte një Rregullore e brendshme e UV (kreu V, Neni 49), në bazë të së cilës, me propozim të titullarit ciklet e leksioneve dhe literature e përdorur duhet të miratohet çdo fillim viti nga Departamenti i Kimisë (evidencat II.12 dhe II.13).</p> |

| | |
|---|---|
| | <p>Në këtë mënyrë studentëve u ofrohen materiale në gjuhën shqipe për profillin përkatës si edhe materiale ndihmëse në shqip ose gjuhë të huaj. Për këto të fundit aktualisht UV po bën përpjekje për qasjen në këtë literaturë nëpërmje platformës “online”: www.ulibrary.rash.al. Me qëllim përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit Drejtuesi i Departamentit të Kimisë, UV ka bashkëpunuar me kolegë të universiteteve të tjera vendase për aplikim projekti në këtë drejtim.</p> <p><i>Përtej përpjekjeve të stafit të Departamentit të Kimisë për të siguruar literaturën bashkëkohore të nevojshme profesionale për leksione, seminare dhe laboratore, konstatohet se për shkak të numrit të kufizuar të tyre, përditësimi i shpeshtë i literaturës në shqip është i vështirë. Pjesa dërrmuese e literaturës në formën e teksteve mësimore në shqip është e huazuar nga literatura aktuale e përdorur në FSHN, UT (referuar “footnote” 175 (link-u përkatës³) në RVB). Për të mundësuar përditësimin e saj kërkohet jo vetëm rritja e numrit të stafit aktual por edhe kualifikimi i mëtjshëm i tij.</i></p> |
| <p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV dhe RVB konstatohet se programi i studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) përmban lëndë kimike bazë të cilat i mundësojnë studentëve një kulturë të përgjithshme dhe lëndët profesionale të cilat i thellojnë dijet e studentëve në aspekte më të specializuara të profilit kimik (evidencat I.6 dhe I.7). Përzgjedhja e lëndëve të programit nga Departamenti i Kimisë, UV është bazuar në programet e ngjashme të ofruara nga FSHN, UT dhe nga universitetet perendimore.</p> <p><i>Për të pasuruar edhe më tej aftësitë dhe kompetencat e studentëve të cilët ndjekin Ciklin e Parë (Bachelor në “Kimi”), rekomandohet që spektri i lëndëve formuese bazë por edhe atyre të formimit integruar të pasurohet më tej duke shtuar disiplina si Kristalografia, Kimi Koloidale Nanoteknologjia, etj (referuar Tabelave 10 dhe 11 në RVB).</i></p> |
| <p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtjshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> | <p>Meqenëse programi i studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) është i strukturuar në mënyrë të ngjashme jo vetëm me programet e të njejtit profil brenda vendit por edhe me programe të ngjashme ndërkombëtare, në përputhje me sistemin Europian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ECTS), i cili u mundëson studentëve për t’u përfshirë në tregun e punës vendas apo të huaj ose për të vazhduar më tej studimet në Master Profesional/Shkencor, brenda (evidenca II.14) ose jashtë vendit.</p> <p><i>Megjithatë, për të vrojtuar shkallën e përputhshmërisë së programit me pritshmëritë e tregut të punës vendas, nga UV duhen kryer sondazhe apo studime të vazhdueshme, të cilat mund të nxjerrin në pah përparësitë apo pikat e dobëta të tij, si dhe të sugjerojnë përmirësime të caktuara në të. Referuar Tabelës 23 në RVB dhe evidencës II.15 vlerësojmë se nevojiten “database” i plotë i të dhënave mbi punësimin e studentëve.</i></p> |

³<https://sites.google.com/a/fshn.edu.al/departamenti-i-kimisee/studime-te-nivelit-te-pare>

| | | | | |
|--|--|-----------------------------|----------------------------|-----------------------------|
| <p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV, RVB dhe diskutimin “online” me përfaqësuesit e Departamentit të Kimisë u konstatua se UV organizon Workshop-e me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorëve, ekspertëve të jashtëm dhe Alumni për të përmirësuar përbajtjen e programeve të studimit në përputhje me kërkesat e tregut të punës (evidenca II.16).</p> <p><i>Megjithatë, sugjerohet që workshop-e të kësaj natyre të organizohen specifikisht për Departamentin e Kimisë, të cilat mundësisht të ndërthuren me sondazhe apo studime të vazhdueshme të kërkesave të tregut të punës për përshtatjen sa më mirë të programit të studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) me ato kërkesa.</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përbushet</p> | <p>Përbushet pjesërisht</p> | <p>Përbushet kryesisht</p> | <p>Përbushet plotësisht</p> |
| | | | <p>X</p> | |

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
|---|---|
| <p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV dhe RVB konstatohet se personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme (referuar Tabelës 1 në RVB), që angazhohet në realizimin e programit të studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) i përbush kërkesat ligjore në fuqi (Ligji 80/2015, neni 59, pika 6).</p> <p><i>Rekomandohet rritje e numrit të personelit akademik të brendshëm për të ulur ngarkesën e orëve mësimore për personel akademik e cila do të mundësonte cilësi më të lartë të mësimdhënies (referuar Tabelë 12 në RVB).</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV dhe RVB konstatohet se personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) kanë kualifikimet e nevojshme për drejtimin e programit dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve mësimore të programit të studimit (referuar Tabelës 12 në RVB).</p> <p><i>Megjithatë rekomandohet që për të rritur cilësinë e mësimdhënies kërkohet jo vetëm rritja e numrit të personelit akademik me kohë të plotë por edhe kualifikimi i mëtijshëm i tij.</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit,</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV dhe RVB konstatohet se personeli akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) kanë kualifikimin e nevojshëm. Fusha akademike-kërkimore e përgjishme dhe specifike është në përputhje me</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. | programin e studimit, natyrën dhe specifikën e lëndëve të tij (referuar Tabelë 12 në RVB). | | | |
| Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV, RVB dhe diskutimin “online” me përfaqësuesit e Departamentit të Kimisë u konstatua se FSHNT, UV dhe konkretisht Departamenti i Kimisë ka marrëveshje bashkëpunimi me fakultete/universitete brenda vendit, (FSHN, UT) dhe me ente publike si p.sh. Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB, Vlorë) (evidenca I.32). Në bashkëpunimi me këto institucione, Departamenti i Kimisë vë në dispozicion personelin akademik për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e punimit të diplomës apo veprimtari të tjera të studentëve. Konstatohet gjithashtu se në pogramin e Cikli të Parë (Bachelor në “Kimi”) nuk përmbahet/ofrohet praktika profesionale. | | | |
| Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV, RVB dhe diskutimin “online” me përfaqësuesit e Departamentit të Kimisë u konstatua se Departamenti i Kimisë ka në strukturë personel ndihmës akademik me karakter mësimor për realizimin e orëve laboratorike. Punonjësja ndihmës akademike e Qendrës Kërkimore Shkencore të FSHT ndihmon në zhvillimin e orëve laboratorike dhe në zhvillimin kërkimor e shkencor të stafit akademik të Departamentit të Kimisë (evidenca II.22). <i>Në lidhje me lëndët që mbulon Departamenti i Kimisë për programin Bachelor në “Kimi” vihet re një mungesë e stafit ndihmës akademik që do të mundëonte ndihmën në zhvillimin e plotë dhe cilësor të të gjitha punëve të laboratorit, mirëmbajtjen e pajisjeve dhe laboratorëve, për këtë qëllim rekomandohet shtimi i numrit të personelit ndihmës akademik që mund të asistojnë në laboratorët e Kimisë Inorganike, Kimisë Organike, Kimisë Fizike e Koloidale, etj (evidenca II.22).</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

| | | | | |
|--|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| Standardi III.1 | |
|---|--|
| Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV dhe RVB konstatohet se UV ka një Udhëzues (evidenca N) në nivel institucional (të miratuar nga Rektorati dhe Senati Akademik i UV) për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme të reja të mësimdhënies në varësi të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. Gjithashtu UV ka përpiluar dhe miratuar Strategjinë e Integritit dhe Trajnimit të Personelit Akademik (evidenca III.1). Për më tepër, një rol ndihmës në ofrimin e moduleve trajnuese të personelit akademik në fushën e mësimdhënies e luan edhe Qendra për Zhvillim Rajonal (RDC), e ngritur në kuadër të projektit U3M-AL. |
| Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV, RVB dhe bisedat “online” me personelin akademik dhe ndihmës akademik të Departamentit të Kimisë, si edhe me studentët e viteve të II, III, konstatohet se monitorimi dhe vlerësimi në mënyrë periodike i aftësisë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik kryhet nëpërmjet Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (NJVSBCI). Kjo njësi është ngritur mbi bazë universiteti (evidencat A dhe III.3). Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion vihet re se monitorimi dhe vlerësimi nga kjo strukturë mbështetet në udhëzimet e ASCAL dhe bazohet në analizën statistikore të informacioneve të përfuara nga pyetësorët me studentët (evidenca III.4). Bazuar nga sa më lartë, përmbushet edhe Kriteri 3 (Standardi III.1) ku në vlerësimin periodik të formave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve përfshihen edhe studentët. Rekomandohet që një njësi e tillë e monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike e aftësisë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik të ngrihet nga vetë FSHNT. |
| Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve. | Bazuar nga sa më lartë, përmbushet edhe Kriteri 3 (Standardi III.1) ku në vlerësimin periodik të formave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve përfshihen edhe studentët. Rekomandohet që një njësi e tillë e monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike e aftësisë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik të ngrihet nga vetë FSHNT. |
| Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Bazuar në komentet e Kritereve 2 dhe 3 më lart, rezulton se NJVSBC i publikon rezultatet e vlerësimit mbi bazë universiteti (evidencat L dhe K). Rekomandohet që rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit të mësimdhënies të personelit akademik dhe ndihmës akademik të Departamentit të Kimisë të publikohen veçmas, në kuadër të FSHNT. |
| Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV, RVB dhe bisedat “online” me personelin akademik dhe |

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. | ndihmës akademik të Departamentit të Kimisë konstatohet se ky departament pasqyron dhe nxit shembuj të praktikave më të mira bazuar në analizën vjetore të cilësisë së mësimdhënies (evidenca III.11). Ngritjen e performancës në mësimdhënie departamenti e ka promovuar duke a) ftuar profesorë të spikatur të fushës me aktivitet të pasur mësimdhënës e kërkimor; b) duke inkurajuar përfshirjen e pedagogëve në programet e ndryshme të mobilitetit; c) duke rimbursuar shpenzimet për kërkim shkencor (konferenca shkencore, publikime, etj.). | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV, RVB dhe bisedat “online” me personelin akademik të Departamentit të Kimisë, si edhe me studentët u konstatua se format e mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë në përputhje (evidenca I.7) me përcaktimet ligjore dhe nënligjore në fuqi (Ligji i Arsimit të Lartë; VKM 41, dt. 24.01.2018) dhe kategorizohen në leksione, seminare, laboratore, detyra kursi/projekte, leksione të hapura (evidenca I.37) nga profesorë të ftuar. etj. Departamenti i Kimisë nuk e ka të përfshirë në programin e Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) praktikën profesionale. |
| Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV, RVB dhe bisedat “online” me personelin akademik të Departamentit të Kimisë, si edhe me studentët u konstatua se format e mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive në programin e Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) janë ato konvencionale. Megjithatë, vitet e fundit raportohet aplikimi i formave alternative të mësimdhënies duke përdorur teknologjinë (video-projektor, laptop etj.) (evidenca III.13). Gjithashtu u konstatua se personeli akademik, ndihmës akademik është i gatshëm të pranojë, respektojë dhe ofrojë mënyra alternative të mësimdhënies kur është e nevojshme për studentë me aftësi të veçanta ose të kufizuara kur kërkohet (pavarësisht se deri në fazën e raportimit kjo kërkesë nuk ka qenë e nevojshme). <i>Vërehet se vështirësia për përmbushjen e plotë të këtij kriteri paraqet jo vetëm mungesa e infrastrukturës së nevojshme por edhe materialeve didaktike në ndihmë të mësimdhënies/mësimnxënies alternative.</i> |
| Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible | Në sajë të bashkëpunimeve me universitete partnere në kuadër të programeve të shkëmbimit (Erasmus + dhe Mevlana), UV dhe specifikisht Departamenti i Kimisë e nxit dhe mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në mobilitete për zhvillim kapacitetesh didaktike dhe kërkimorë-shkencorë (evidencat III.13 dhe III.15). Bazuar |

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë


E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 24

| | | | | |
|--|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. | në dokumentacionin e paraqitur (Strategjia e Integritit dhe Trajnimit të stafit të UV) (evidenca III.1) vihet re se nxitja dhe mbështetja e personelit akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike është pjesë e politikave që ndjek UV. Gjithashtu bazuar në infrastrukturën e përshtatshme të FSHT, UV dhe nëpërmjet “Udhëzuesit për përdorimin e metodave të mësimdhënies” (evidenca N), të miratuar nga Senati Akademik i UV, mundësohet përdorimi i metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. | | | |
| Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. | Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) përbëhet nga staf akademik me kohë të plotë dhe staf akademik i ftuar (nga FSHN, UT). Bazuar në kualifikimet shkencore të stafit akademik të ftuar dhe atij me kohë të plotë (referuar Tabelës 12 në RVB), si edhe në materialet didaktike që përdorin vihet re kompetencë në transmetimin e njohurive dhe koncepteve. Ky staf akademik përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përshtatur sipas pecifikave të lëndës (lëndëve) që drejton. Bazuar në bisedat “online” me personelin akademik të Departamentit të Kimisë u konstatua se pothuajse i gjithë stafi akademik me kohë të plotë i Departamentit të Kimisë ishte i angazhuar në proces kualifikimi shkencor (grada shkencore/tituj akademikë). <i>Për të rritur cilësinë e mësimdhënies rekomandohet jo vetëm rritja e numrit të personelit akademik me kohë të plotë por edhe e kuafikimit të mëtijshëm të tij.</i> | | | |
| Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Kimisë së UV, RVB dhe bisedat “online” me personelin akademik të Departamentit të Kimisë, si edhe me studentët u konstatua se Departamenti i Kimisë në takimet e tij e diskuton në mënyrë periodike përmirësimin e formave të mësimdhënies, duke konsideruar kërkesat, rekomandimet dhe sugjerimet e studentëve (evidenca I.19). | | | |
| Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi. | Bazuar në bisedat “online” me personelin akademik të Departamentit të Kimisë dhe studentët u konstatua se përveç metodave konvencionale të mësimdhënies përdoren gjithmonë e më shumë metodat plotësuese interaktive (si shpjegimi dhe vizualizimi me video-projektor), demonstrimi dhe diskutimi i matjeve eksperimentale pranë pajisjeve matëse, etj (evidencat III.17 dhe III.18). | | | |
| Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Bazuar në bisedat “online” me personelin akademik të Departamentit të Kimisë dhe studentët u konstatua se metodat e mësimdhënies (laboratore në grupe të vegjël, detyra kursi dhe detyra individuale) (evidencat III.17 dhe III.18), pjesë e programit të Ciklit të Parë (Bachelor në “Kimi”) e inkurajojnë sensin e autonomisë tek studenti. Komunikimi i vazhdueshëm i stafit akademik me studentët ndihmon në ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë pedagog-student. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |



Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. | <p>DK ka ambiente të dedikuara me hapësira të mjaftueshme për zhvillimin cilësor të mësimin. Proçesi mësimor i programit të Ciklit të Parë Bachelor në “Kimi” zhvillohet në ambientet e Godinës C, të Fakultetit të Shkencave Teknike. DK ka në shërbimin e tij personel sanitar i cili mirëmban ambientet e Godinës C ku edhe zhvillohet mësimi (referuar Tabelës 16 në RVB).</p> <p>Referuar RVB, Godina C e cila është 5 (pesë) katëshe ka në përbërjen e saj 3 (tre) salla leksionesh, 14 (katërbëdhjetë) salla seminaresh dhe 6 (gjashtë) laboratorë ku edhe zhvillohen lëndë të ndryshme siç janë Kimia, Biologjia, Informatika, Fizikë, etj. Të gjitha ambientet e Godinës C janë funksionale dhe kanë të gjitha kushtet e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor.</p> <p>Sipërfaqja e Godinës C është 2900 m² dhe brenda kësaj hapësire Departamenti i Kimisë zhvillon proçesin e mësimor-kërkimor. Për shkak të numrit të vogël të studentëve raporti student/sipërfaqe është brenda standardit të vendosur nga VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 (1 student/5 m²) (referuar Tabelës 16 në RVB)</p> <p><i>GVJ vëren se në RVB është raportuar 1 student/2.9 m². Gjithsesi kjo shifër i përket raportit student/sipërfaqe në nivel universiteti (referuar Tabelës 16 në RVB).</i></p> |
| Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor. | <p>Referuar vizitave “online” GVJ konstatoi se ambientet ku zhvillohet procesi mësimor janë funksionale dhe të mirëpajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të mësimdhënies.</p> <p>Konkretisht, sallat e leksioneve dhe të seminareve kanë të përcaktuar numrin e posteve si dhe numrin e studentëve të planifikuar për të zhvilluar mësimin. Personeli akademik zotëron videoprojektorë portabël për zhvillimin e procesit mësimor. Sallat janë të pajisuara, gjithashtu edhe dërrasë të zezë ose <i>White board</i> (evidencat III.14, III.15 dhe III.16).</p> <p>Për mirëfunksionimin e seancave laboratorike Qendra Kërkimore Shkencore zotëron të gjitha pajisjet e nevojshme të parashikuara në planin mësimor të programit.</p> |
| Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. | <p>FSHT/DK zotëron një sistem informatik të konsoliduar (evidenca III.21 dhe Tabela 17 në RVB) . Godina C ku DK zhvillon aktivitetin e tij mësimor-kërkimor ka lidhje fikse interneti wi-fi në të gjithë hapësirën e tij. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Mësimor të UV-së me akronimin UVMS (University of Vlora Management System) është vënë në shërbim të plotë të personelit akademik dhe studentëve. Ky sistem i ofron stafit akademik dhe studentëve adresa zyrtare të e-mail-ve</p> |

| | |
|---|--|
| | (emer.mbiemer@univlora.edu.al) nëpërmjet të cilave mundësohet komunikimi i rregullt staf akademik - student dhe anasjelltas. |
| Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit. | GVJ vëren se gjatë përditësimit të përvitshëm të syllabuseve, DK miraton edhe literaturën bazë të çdo lënde. Literatura e programit të studimit është në gjuhën shqipe dhe disponohet në formën e teksteve mësimore ose në formë të printuar (evidencat III.23 dhe III.24). DK vë në përdorim edhe tekste mësimore të IAL-ve të tjera si UT/FSHN. Përveç literaturës bazë në syllabusin e lëndës është përcaktuar edhe literatura ndihmëse e cila rekomandohet kryesisht nga biblioteka “online” ulibrary.rash.al duke krijuar në këtë mënyrë lehtësinë e aksesimit nga ana e të gjithë studentëve. |
| Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. | Referuar RVB dhe vizitave “online”, GVJ konstatoi se biblioteka e IAL garanton një numër të mjaftueshëm të botimeve në drejtimet kryesore të programit. Konkretisht, UV ofron 3 (tre) biblioteka me 3 (tre) salla leximi njëra prej të cilave ndodhet në ambientet e FSHT. Biblioteka e FSHT-së zotëron një numër të madh titujsh në total 723 vëllime, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera (evidencat III.23). Gjithashtu, për garantimin e botimeve të viteve të fundit, DK parashikon në buxhetin e tij fonde për blerje literature duke përditësuar në këtë mënyrë kurrikulën e programit. |
| Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. | GVJ konstaton se personeli akademik dhe studentët e IAL kanë akses të plotë në https://ulibrary.rash.al/ , ku mund të gjejnë literaturë të fushave të ngjashme me programin e studimit (evidenca III.23). Gjithashtu, IAL bashkëpunon me rrjete të tjera elektronike si p.sh. burimet elektronike për Shqipërinë [(Electronic Resources for Albania (ERA2012 Project)], mbështetur nga IZUM/ Qendra Rajonale për Sistemet e Informimit Bibliotekar dhe Sistemet e Informacionit Kërkimor etj. |
| Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. | Referuar RVB rezultoi se të gjitha ambientet laboratorike të FSHT janë të hapura në orarin zyrtar 8.00-16.00. Në dispozicion të këtyre laboratorëve DK ka 3 (tre) laborantë (personel ndihmës akademik) me kohë të plotë. Për zhvillimin e detyrave të kursit dhe temave të diplomave përveç ambienteve laboratorike studentët kanë në shërbim të tyre edhe ambientet e bibliotekës (godina C- evidenca III.23) si dhe akses të plotë në përdorimin e internetit. |
| Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre. | Konstatohet se platforma e-learning https://ulibrary.rash.al/ është vënë në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies nga ana personelit akademik dhe studentëve respektivisht. |
| Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar. | Personeli akademik dhe studentët kanë akses të plotë në platformën elektronike UMS. Kjo platformë realizon komunikimin midis studentëve dhe personelit akademik për të gjitha lëndët e planit mësimor të programit të studimit (evidencat III.26 dhe III.27). Nëpërmjet link-ut https://uvms.univlora.edu.al/user/login , studentët kanë akses në hapësirën e tyre personale elektronike. Nëpërmjet kësaj hapësire studentët regjistrohen në provimet e sezonit dhe aksesojnë lehtësisht materialet e ngarkuara nga titullarët e lëndëve. |
| Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në | Referuar Rregullores të DK, lista e temave për mbrojtjen e Diplomës, diskutohet në mbledhjen e Departamentit dhe pas miratimit të tyre, |

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 27

| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre. | Përgjegjësi i DK zbardh vendimin dhe i dorëzon ato në sekretarinë mësimore (evidenca III.28). Personeli akademik i ngarkuar për udhëheqjen e studentëve në punimin e temës së diplomës i orienton ata në përzgjedhjen e temave dhe i asiston për zhvillimin e tyre. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |


| Standardi III.4 | |
|--|---|
| Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies. | Në funksion të përmirësimin të vazhdueshëm të mësimdhënies IAL ka ngritur Strukturën e Njësisë të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) (evidenca III.30). Kjo njësi funksionon në nivel institucional. NJSBC koordinon dhe bashkërendon aktivitetet e saj me njësitë kryesore dhe ato bazë. Në këtë kuadër janë përpiluar pyetësorët e studentëve të cilat synojnë vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Analiza e pyetësorëve identifikon më tej pikat e forta dhe të dobëta. <i>Referuar RVB, GVJ konstaton pyetësorë vetëm për 2 (dy) vite akademike 2017-2018 dhe 2018-2019 (evidenca L) dhe raport mbi rezultatet e pyetësorit vetëm për 1 (një) vit akademik, 2018-2019. Sugjerohen rekomandimet e dhëna tek Standardi VI.1 (kriteri 1).</i> |
| Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personelit akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron. | Referuar RVB, mënyrat me të cilat njësia kryesore dhe ajo bazë monitoron cilësinë e mësimdhënies janë nëpërmjet raportimeve vjetore, promovimit të kualifikimit të personelit akademik, trajnimeve periodike, pyetësorëve apo sondazheve të studentëve, mbledhjeve të departamentit të cilat janë periodike (evidencat L, III.31, III.32). |
| Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. | Në funksion të zhvillimit të metodave të reja inovative të mësimdhënies, IAL ka ngritur në nivel institucional Qendrën Studimore Ndërdisciplinore për Zhvillimin Rajonal (evidenca I.28). Kjo qendër synon zhvillimin dhe mbështetjen e metodave bashkëkohore të mësimdhënies. Në këtë kuadër, qendra ofron trajnime për mësimdhënien, aplikime për projekte etj. Qendra studimore ka përpiluar edhe një Udhëzues të posaçëm mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies sipas fushës të studimit në IAL. |
| Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Në kuadër të kualifikimit të vazhdueshëm të personelit akademik, FSHT/DK organizon aktivitete të ndryshme në fushën e kërkimit shkencor. Këtu përfshihen pjesëmarrjet në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirja apo angazhimi në projekte të ndryshme, organizimi i seminareve apo trajnimeve të ndryshme të mundësuar nga programi i mobiliteteve ERASMUS+. |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | Përsa më sipër GVJ vëren se të gjitha këto aktivitete vihen në funksion të plotë të përmirësimit të mëtejshëm të mësimdhënies (evidencat I.31 dhe III.33, Tabelat 19 dhe 20 në RVB). | | | |
| Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. | Referuar RVB, konstatohet se në kuadër të përmirësimit të aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja, njësia kryesore dhe ajo bazë ofron trajnime të vazhdueshme për personelin akademik (evidencat I.30 dhe I.31). | | | |
| Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. | Përveç programit të mobiliteteve të ofruar nga programi ERASMUS+, IAL ofron trajnime të ndryshme nëpërmjet Qendrës Studimore Ndërdisciplinore për Zhvillimin Rajonal (evidenca III.2). Këtu mund të përmenden modulet trajnuese “Meodologjitë e mësimdhënies” (TEAVET) dhe “Menaxhimi i klasës” (TEAVET), të organizuara në kuadër të projektit “Developing teacher competencies for a comprehensive VET system in Albania.” https://teavet.org/ | | | |
| Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. | Referuar vlerësimit tonë të kriterëve më sipër, vërehet se personeli akademik angazhohet maksimalisht në aktivitete të ndryshme për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Gjithsesi, referuar kriterit 7, në RVB deklarohet se testimi i metodave të reja në mësimdhënie nga personeli akademik nuk bën të mundur të analizohen efektet dhe pritshmëritë mbi rezultatet. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

| Standardi III.5 | |
|---|--|
| Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Studentët e Programit të Ciklit të Parë Bachelor në “Kimi” mund të informohen në lidhje me kriteret dhe mënyrat e testimit të vlerësimit të njohurive, dijeve si dhe aftësive profesionale nëpërmjet Rregullores së IAL (evidenca C) e cila gjendet në faqen zyrtare të UV (https://univlora.edu.al/rregullorja/). Në funksion të këtij informacioni janë edhe Rregullorja e DK si dhe në Rregullorja e Programit të Studimit. Gjithashtu studentët mund të kontaktojnë edhe koordinatorin e programit i cili informon ata mbi kriteret dhe mënyrat e testimit të njohurive. |
| Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Referuar vlerësimit tonë më sipër (Kriteri 1), Rregullorja e IAL ka të gjithë informacionin e duhur mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të lëndëve të programit (evidencat I.2 dhe II.1). Ky informacion përcillet gjithashtu tek studentët nga titullarët e lëndëve gjatë prezantimit të syllabusit në javën e parë të mësimin. Syllabusi i lëndës përmban të gjithë elementët e nevojshëm për mënyrën se si studentët do të testohen, vlerësimin e njohurive etj. |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Referuar RVB (Tabelat 10 dhe 11 në RVB), Programit i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Kimi” ka përfshirë në planin e tij mësimor disa mënyra dhe forma të ndryshme të testimit të njohurive për studentët. Studentët mund të testohen me shkrim me gojë dhe vlerësim të vazhduar. Të gjitha mënyrat e testimit jepen të plota në syllabuset e lëndëve. Mënyrat e ndryshme të testimit u japin studentëve mundësinë për të demonstruar njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë zhvillimit të lëndës ose modulit. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| Standardi III.6 | |
|--|---|
| Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik. | Në syllabuset e lëndëve të programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Kimi” është përcaktuar qartë testimi, vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale të studentëve përgjatë vitit akademik (evidenca I.7). Konkretisht testimet e pjesshme kanë peshën e 30-40% të pikëve të vlerësimit total. Vlerësimet e seancave laboratorike kanë peshën e 10-20 % të pikëve të vlerësimit total. Për lëndët me vlerësim të vazhduar kryhen testime përgjatë vitit ose semestrit (deri në 3 testime për semestër). |
| Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Në RVB raportohet se IAL/DK nuk ka vënë zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit për studentët për shkak të mungesës së infrastrukturës së nevojshme teknologjike. Gjithsesi në dijeninë tonë si dhe referuar bisedave “online” në dy vite akademike (2019-2020 dhe 2021-2021) është vënë në zbatim përdorimi mësimi i “online” në UV i cili mundëson edhe testimin elektronik të studentëve. |
| Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës ose modulit. | Testimi dhe vlerësimi i njohurive dhe dijeve të studentëve realizohet, referuar RVB, në përgjithësi nëpërmjet provimeve me shkrim (evidenca II.1). Komisionet e provimeve përbëhen nga 2 (dy) anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës ose modulit. Tezat e provimeve përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm siç janë emri i studentit/tes, kodi i lëndës, emri i pedagogut, pikëzimin e pyetjeve etj. Tezat e provimeve hartohen nga titullari i lëndës dhe firmosen nga Përgjegjësi i Departamentit. |
| Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi. | Në RVB deklarohet se DK nuk ka vënë në zbatim testimin e vlerësimit të njohurive apo dijeve me shkrim nëpërmjet zhvillimit anonim me sekretim ose kodifikim (evidenca II.1). Kjo për shkak se numri i studentëve është i vogël dhe nuk është e nevojshme që IAL të sigurojë infrastrukturën e duhur për zhvillimin e provimeve me sekretim apo kodifikim. Monitorimi i provimeve mund të realizohet lehtësisht nga personeli akademik. |
| Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet | Referuar RVB, dhe takimeve “online” me studentët, pas përfundimit të provimit, studenti/tja ka të drejtë të ri-shikojë provimin dhe vlerësimin e dhënë nga titullari i lëndës. Vlerësimet janë të shoqëruara me komente |





| | | | | | | | | | |
|--|---|-----------------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|--|--|--|----------|
| dhe me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | dhe këshilla që e ndihmojnë studentin/ten në procesin e të nxënimit. Komentet apo këshillat e titullarit ndihmojnë gjithashtu studentët për t'u përmisuar në të ardhmen. | | | | | | | | |
| Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik. | Bazuar në Rregulloren e IAL (evidenca C), Rregulloren e DK (evidenca I.2) si edhe në Rregulloren e Programit (evidenca II.1), në rastet e konstatimeve të kopjimeve në provime apo detyrat e kursit, personeli akademik i tërheq studentit/tes vërejtje me gojë dhe i zeron pikët e vlerësimit. | | | | | | | | |
| Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Referuar RVB (evidenca C) dhe takimeve “online” me studentët konstantohet se ata mund të marrin vlerësimin e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale brenda 48 orëve nga dita e zhvillimit të provimit. Rezultat e provimeve hidhen në sistemin elektronik UVMS duke siguruar në këtë mënyrë konfidencialitetin e rezultatit. | | | | | | | | |
| Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Në të gjitha Rregulloret e tij (evidencat I.2 dhe II.1), DK ka garantuar të drejtën e studentëve për t'u njohur me vlerësimin e provimit nga titullari i lëndës, si dhe kërkesën për rishikim të këtij vlerësimi. Gjithashtu, për sqarime të mëtejshme studenti/tja ka të drejtën t'i drejtohet edhe Përgjegjësit të Departamentit. Gjetje të tilla u konstatuan nga GVJ edhe gjatë takimeve “online” me studentët. | | | | | | | | |
| Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet. | Referuar vlerësimit tonë të kriterit më sipër (Kriteri 8), DK ka sanksionuar në të gjitha Rregulloret e tij (evidencat I.2 dhe II.1) të drejtën e studentit/tes për rishikim, kërkesë apo ankimim të vlerësimit të provimit. Procedura për ankimim përfshin dorëzimin e kërkesës nga ana e studentit/tes pranë sekretarisë mësimore, brenda 48 orëve nga marrja e rezultatit. Përgjegjësi i Departamentit shqyrton kërkesën dhe bën të mundur zgjidhjen e ankesës. E gjithë procedura dokumentohet dhe arkivohet. | | | | | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | <table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table> | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | X |
| Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Programi i Ciklit të Parë Bachelor në “Kimi” përfshin disiplinat kryesore të kimisë, ku studentët mund të marrin formim bazë dhe karakterizues. Fitimi i njohurive praktike arrihet nëpërmjet orëve të konsiderueshme të seancave laboratorike të çdo lënde (evidenca I.5). Nëpërmjet këtyre disiplinave studentët fitojnë njohuri të përgjithshme në fushën e kimisë inorganike, analitike, organike, kimisë fizike, strukturës së lëndës dhe metodave instrumentale të analizës. Ky spektër i gjerë lëndësh garanton thellimin e njohurive dhe zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. |

| | |
|--|--|
| | <i>Në vijim të vlerësimit tonë (Standardi II.4, kriteri 3), rekomandohet rritja e numrit të lëndëve që ofrohen në program p.sh. Kimi Koloidale duke ri-shpërndarë kreditet ekzistuese të lëndëve aktuale. Shtimi i lëndëve të reja ofron mundësinë e thellimit të mëtejshëm të njohurive profesionale (evidenca I.5).</i> |
| Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Referuar RVB, plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Kimi” (evidenca I.5 dhe Tabelat 10, 11 në RVB) përmban modulet e Teknologjisë së Informacionit dhe Gjuhës së Huaj, si dhe “Statistika në Kiminë Analitike” duke garantuar në këtë mënyrë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit. |
| Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde. | Nga takimet “online” me personelin akademik dhe studentët rezultojnë se java e fundit e semestrit vihet në përdorim të përmbledhjes të çështjeve më të rëndësishme të zhvilluara përgjatë lëndës si dhe të konsultimeve sipas nevojave të studentëve. |
| Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre. | Një rëndësi të veçantë në këtë përmbledhje kanë përfundimi i seancave laboratorike ku nëpërmjet dorëzimit të detyrave apo punëve laboratorike (grafikët, llogaritjet, përfundimet e nxjerra) analizohen kompetencat dhe aftësitë profesionale që ka fituar çdo student (evidenca I.7). |
| Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. | Referuar RVB, rezultojnë se DK sistematikisht organizon leksione të hapura, seminare apo konferenca në funksion të përditësimit të njohurive të reja të shkencës dhe teknologjisë. Studentët aktivizohen rregullisht në organizimin e këtyre aktiviteteve (evidenca I.37). |
| Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. | Syllabuset e programit të studimit Bachelor në “Kimi” rezultojnë të kenë të përfshira rezultatet e të nxëniet në formën kompetencave që studenti/tja fiton gjatë zhvillimit të modulit (evidenca I.7). Në veçanti një peshë specifike u jepet njohurive praktike të fituara gjatë seancave laboratorike ku studentët vënë në zbatim njohuritë teorike të marra gjatë orëve të leksioneve dhe seminareve. |
| Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara. | Referuar RVB dhe takimeve “online” me studentët rezultoi se gjatë zhvillimit të leksioneve dhe seminareve, personeli akademik ju cakton atyre detyra kurse apo probleme në formën e ushtrimeve duke nxjerrur në këtë mënyrë diskutimin dhe punën në grup për zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara (evidenca III.18). |
| Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve. | Në Planin e tij Strategjik (evidenca I.3), Departamenti i Kimisë ka përfshirë integrimin e studentëve me mesatare të lartë në punën kërkimore shkencore. Studentët cilësorë kanë mundësinë të kryejnë studime të thellura dhe të avancuara gjatë punimit të temës së diplomës pranë Qendrës Kërkimore Shkencore duke patur mbështetjen e plotë të personelit akademik dhe ndihmës akademik. |
| Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët. | Përveç mundësive të punimeve të temave të diplomës, studentët mund të punojnë në mënyrë individuale apo në grup për detyra të ndryshme kurse. Referuar takimeve “online” me studentët, në mbështetje të studimeve kërkimore, DK ofron mbështetje financiare për studentët e tij nëpërmjet bursave të mobiliteteve. |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|--|
| <p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p> | <p>Një nga programet më të njohura ku DK është angazhuar maksimalisht është ai i ERASMUS + (evidenca I.31). Bashkëpunimi me këtë program i jep personelit akademik mundësinë për të ndërthurur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese e cila më tej krijon mundësinë për të rritur mobilitetin e studentëve.</p> <p>Referuar RVB dhe takimeve “online” me studentët u konstatua se studentët kanë qenë të mirëinformuar për mundësinë e programit të mobilitetit. <i>Gjithsesi asnjë prej tyre nuk shprehu interes apo dëshirë për pjesëmarrje në këto mobilitete.</i></p> <p><i>Sugjerohet se FSHT/DK duhet të ndjekë një politikë më nxitëse për të përfshirë studentët (edhe pse numri i tyre është i vogël) në programet e mobilitetit. Gjithashtu përgjatë RVB vihet re se vetëm një anëtar i DK ka marrë pjesë në programin e mobilitetit (Evidenca I.31: Mobilitet stafi për trajnim dhe mësimdhënie (Prof. As. Flora Qarri, University of Vigo, Spanjë). Rekomandohet pjesëmarrje aktive e personelit akademik në programet e mobilitetit.</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

| <p>Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p> | |
|--|---|
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p> | <p>Bazuar në RVB, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se IAL/DK ka hartuar të gjitha procedurat e nevojshme për provimin final dhe mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve (evidencat I.2, II.1, III.42, III.43). Këto procedura janë përcaktuar qartë në Rregulloren e Programit, Rregulloren e Departamentit dhe Rregulloren e Diplomimit. Të gjitha procedurat janë të publikuara në faqen zyrtare të departamentit https://univlora.edu.al/departamenti-i-kimise/. Për sqarime shtesë studentët mund të kontaktojnë këshilltarin akademik, sekretarinë mësimore si dhe Përgjegjësën e Departamentit.</p> |
| <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p> | <p>Referuar RVB (evidenca II.1), vërehet se struktura përgjegjëse, sekretaria mësimore dhe personeli akademik i cili ka hartuar tezën e pyetjeve apo ka udhëhequr temat e diplomave ndihmojnë studentët me materiale dhe udhëzime të cilat vihen në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p> |
| <p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p> | <p>Bazuar në evidencat mbështetëse të RVB, GVJ konstaton se komisioni i posaçëm i ngritur për administrimin e provimit final formulon tezën e Provimit të Diplomës të programit të Ciklit të Parë Bachelor në “Kimi”. Lista e pyetjeve të tezës bazohet në 5 (pesë) lëndët karakterizuese të programit të zhvilluara në 3 (tre) vite akademike, sipas peshës specifike në kredite që ka secila prej lëndëve. Këtu përfshihen: Kimi e</p> |

Adresa: “Rruga e Durrësit” , Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 33

| | |
|---|---|
| | Përgjithshme, Kimi Inorganike, Kimi Organike I, II, Kimi Fizike I, II dhe Kimi Analitike I, II (evidenca III.39). |
| Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave. | Bazuar në takimet “online” me Përgjegjësën e Departamentit, stafin akademik, studentët si dhe referuar RVB u konstatua se për Provimin e Diplomës, Departamenti i Kimisë përcakton 3 (tre) muaj para sezonit të provimit të diplomës, lëndët e programit të cilat do të përfshihen në provimin përfundimtar. Në këtë kontekst, titullarët e lëndëve përcaktojnë temat e secilës lëndë prej të cilave nxirren pyetjet e provimit. Informacionin në lidhje me provimin e diplomës studentët e marrin nga DK, afishimet pranë sekretarisë mësimore si dhe në faqen zyrtare të IAL. Departamenti sigurohet që informacioni të arrijë tek studentët 2 (dy) muaj përpara sezonit të diplomës (evidenca II.1) Tema e Diplomës, zgjidhet për studentët me mesatare mbi 9 (nëntë) (referuar takimeve “online”). Ato diskutohen në mbledhjen e DK dhe miratohen nga Përgjegjësi i tij. Ky i fundit pas zbardhjes së vendimit dorëzon temat në sekretarinë mësimore. |
| Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Referuar takimeve “online” me studentët, GVJ vëren se studentët e programit të studimit Bachelor në “Kimi” kanë asistencë të vazhdueshme nga udhëheqësit e tyre të diplomës. Studentët takohen rregullisht me udhëheqësit e tyre për diskutimin dhe përpunimin e rezultateve, shkrimin dhe mbrojtjen e temës (evidenca II.1). Përsa më sipër, referuar vizitës “online” në Qendrën Kërkimore Shkencore (QKSH) u konstatua se kjo qendër u ofron studentëve të programit Bachelor në “Kimi” paisje apo aparatura bashkëkohore për realizimin me sukses të pjesës eksperimentale të punimit të diplomës. |
| Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit. | Në vijim të vlerësimit tonë (kriteret 4 dhe 5), GVJ konstaton se udhëheqësi i diplomës asiston studentin/ten në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës. Me përfundimin e shkrimit të temës, udhëheqësi i studentit/tes dorëzon në sekretari vlerësimin e temës (evidenca II.1). Vlerësimi konsiston në garantimin e cilësinë së rezultateve dhe miratimin nga ana e udhëheqësit të punimit për t’u paraqitur para komisionit. Ky i fundit nëpërmjet miratimit dhe vlerësimit me shkrim të udhëheqësit dhe prezantimit të studentit/tes përpara komisionit jep vlerësimin përfundimtar të punimit të temës. |
| Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Në përputhje me Rregulloren e Programit të Studimit (evidenca II.1) dhe Rregulloren e Diplomimit (evidenca III.42), Komisioni i Diplomimit i ngritur nga DK për të kryer korrigjimin e provimit të zhvilluar nga studentët vlerëson me pikë përgjigjet e pyetjeve të çdo lënde. Secili nga lektorët vlerëson/korrigjon përgjigjet e pyetjeve të lëndës së tij. Përgjegjësi i Departamentit vendos në procesverbal pikët e mbledhura dhe me pikët totale të grumbulluara bëhet vlerësimi me notë në prani të Komisionit të Diplomës. Për vlerësimin e studentit/tes që ka punuar mbi një temë të caktuar, organizohet mbrojtje e hapur. Studenti/tja prezanton punimin e diplomës në formatin “power point” për jo më shumë se 30 min. Në fund të prezantimit komisioni pasi ka dëgjuar edhe vlerësimin e oponentit i |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | adreson studentit/tes pyetje në lidhje me punimin e diplomës. Anëtarët e komisionit japin në përfundim vlerësimin e tyre me pikë dhe nxirret një mesatare aritmetike prej së cilës vendoset nota e punimit të diplomës. | | | |
| Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. | Referuar RVB, GVJ vëren se me përmbushjen e të gjitha detyrimeve akademike dhe financiare nga ana e studentit/tes, Rektori i IAL aprovon kërkesën për diplomim (evidencat I.2, II.1, III.42). Plotësimi i diplomës dhe i suplementit për çdo student/e kryhet nga sekretaria mësimore e DK. Studenti/tja pajiset me diplomën dhe suplementin i cili përshkruan në mënyrë të përgjithshme përmbajtjen e programit dhe rezultatet e studimeve të përfunduara me sukses. | | | |
| Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Bazuar në RVB, studentëve ju vihet në dispozicion kopja e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar (evidenca III.46). Për këtë studentët duhet të paraqiten tek sekretaria mësimore për t'u pajisur me formularin e programit. Më këtë formular studentët bëjnë pagesën në një bankë të nivelit të dytë dhe më pas mund të tërheqin programin e firmosur dhe të vulosur nga Rektori i IAL. Afati kohor për përgatitjen kopjes së plotë zyrtare të programit të studimit është 10 (dhjetë) ditë. | | | |
| Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. | Bazuar në takimin "online" me sekretarinë mësimore si dhe evidencat mbështetëse të RVB, GVJ konstaton se në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 neni 101, sekretaritë mësimore të fakultetit dhe departamentit disponojnë regjistrin themeltar të studentëve me të dhënat personale të tyre, regjistrin e arritjeve akademike si dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave. Regjistri plotësohet në formë të shkruar dhe elektronike dhe ruhet për një periudhë të pacaktuar (evidencat I.2, III.47, III.48). | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT Adela**

| Standardi IV.1 | | | |
|--|---|-----------------------------|-----------------------------|
| Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit | | | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve | | |
| <p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p> | <p>Bazuar në RVB dhe takimet “online” u konstatua se IAL ka një bazë të dhënash të hollësishme dhe të mirëorganizuara për personelin akademik të brendshëm, të ftuar etj. Kjo bazë të dhënash gjendet pranë zyrës të Drejtorisë të Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore të IAL dhe është e përditësuar (evidencat III.20 dhe IV.1).</p> <p>Gjatë takimeve “online” GVJ kërkoi nga zyra e Drejtorisë të Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore të IAL të njiheshin me dy dosje, personel akademik të brendshëm (të punësuar kohët e fundit) dhe të jashtëm ose të ftuar të Departamentit Kimi të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore (FSHTN) (UV). GVJ konstatoi se dosjet ishin te plota dhe pëmbanin të gjithë dokumentacionin/informacionin e nevojshëm përfshirë CV, kërkesat për aplikimin e vendit vakant, fotokopje të noterzuara të diplomave, të titujve dhe gradave, listë notash etj.</p> | | |
| <p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p> | <p>Në bazë të evidencave të paraqitura në RVB si edhe informacionin e publikuar në faqen zyrtare të UV (referuar njoftimeve të vendeve vakante), IAL ka hartuar dhe zbatuar procedurat për rekrutimin e personelit akademik (staf i brendshëm dhe i jashtëm). Procedurat bazohen në statutin, rregulloren e institucionit (evidencat A dhe C), në Kodin e Punës dhe Statutin e personelit akademik.</p> | | |
| <p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p> | <p>Sipas gjetjeve në RVB, si dhe takimeve “online” GVJ konkludon se procedurat për rekrutimin e personelit janë përcaktuar në dokumentacionet bazë, Statut (evidenca A), Rregullore (evidenca C) dhe vihen në funksion të veprimtarisë të IAL. Kriteret e posaçme dhe specifike për të gjitha vendet vakante përcaktohen në departament dhe shpallen në faqen zyrtare të UV⁴ pas miratimit nga Rektori.</p> | | |
| <p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> | <p>Gjatë takimit “online” me zyrën e Drejtorisë të Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore, GVJ u informua se ky sektor në bashkëpunim me njësinë bazë, është përgjegjës për ndjekjen e gjithë procedurës në lidhje me rekrutimet në UV. Vlerësimi i kandidatëve në konkurs bëhet nga komisioni <i>Ad-hoc</i> i cili në bazë të tabelës së pikëzimit, e përdorur për vlerësimin e dosjeve dhe e publikuar në faqen zyrtare të IAL shpall kandidatin fitues. Gjetje të tilla u konstatuan në RVB dhe evidencat mbështetëse (evidencat A dhe I.20).</p> | | |
| | Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht |
| | | | Përbushet plotësisht |

⁴https://univlora.edu.al/#univlora_punesim

| | | | | |
|-------------------------------------|--|--|--|---|
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | | | X |
|-------------------------------------|--|--|--|---|

| Standardi IV.2 | |
|---|--|
| Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. | GVJ vlerëson se personeli i Departamentit të Kimisë (DK) në UV ka hapësira dhe mjedise të dedikuara për personelin akademik dhe sekretarinë mësimore. U evidentua gjatë vizitës “online” se personeli akademik e ushtron aktivitetin e tij tek godinat B dhe C të cilat kanë sipërfaqe akomodimi të mjaftueshme (referuar Tabelës 16. RVB). Të gjitha ambientet rezultuan të pajisura me tavolina pune, kompjutera personalë me lidhje interneti, printera etj. |
| Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. | IAL (UV) rezulton të ketë hartuar Planin Strategjik 2018-2024 (evidenca B), Strategjinë për Kërkimin Shkencor 2017-2022 ⁵ , Strategjinë e Ndërkombëtarizimit 2016-2020 (evidenca D) si dhe Strategjinë për Trajnimin e Vazhdueshëm të Kërkuesve të Rinj (evidenca G). Planet dhe strategjitë të nevojshme për kualifikimin e vazhdueshëm të personelit janë evidentuar nëpërmjet evidencave mbështetëse. Në këtë kuadër, DK ka hartuar edhe planin e tij strategjik. Gjithashtu, në kuadrin e promovimit të personelit akademik GVJ konstatoi se në vitet e fundit 5 (pesë) anëtarë të DK kanë mbrojtur gradën shkencore Dr. Një anëtar i stafit ka marrë titullin Prof. Asoc., ndërsa një anëtar i stafit ka aplikuar për marrjen e titullit Prof. Asoc. GVJ konstatoi gjithashtu, se Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore dhe DK në vitet e fundit ka rritur numrin e marrëveshjeve të lidhura në kuadër të programit Erasmus + dhe të ndërkombëtarizimit (evidenca I.30). |
| Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. | Në përpjekje të përdorimit të metodave të reja të mësimdhënies, UV ka miratuar udhëzuesin përkatës për metodat inovative (evidenca N) dhe ka organizuar në mënyrë të rregullt workshop-e, trajnime dhe leksione te hapura. <i>Në këtë kuadër, GVJ në takimet “online” me studentët konstatoi se lëndë të caktuara në programin Bachelor në “Kimi” si Kimi Fizike I dhe Kimi Fizike II kishin mungesa të tematikave të punëve të laboratorit (të formimit karakterizues) si Kalorimetria, Krioskopia, Ebulioskopia si dhe të pajisjeve didaktike përkatëse.</i> <i>Në vijim të rekomandimeve të dhëna tek standardet I.4 kriteri 1 dhe II.3 kriteri 7, GVJ sugjeron se plotësimi apo pasurimi me tematikat e reja dhe pajisjet didaktike përkatëse është i rëndësishëm për rritjen e</i> |

⁵<https://univlora.edu.al/wp-content/plugins/ari-fancy-lightbox/assets/pdfjs/web/viewer.html?file=https%3A%2F%2Funivlora.edu.al%2Fwp-content%2Fuploads%2F2020%2F02%2Fvendim-nr-103.pdf#page=1&zoom=auto,-12,801>

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>cilësisë të mësimdhënies por edhe për rritjen profesionale të personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor.</i> | | | |
| Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë. | Sipas gjetjeve të GVJ, DK është i mirëorganizuar dhe ka kapacitet të mjaftueshëm të burimeve njerëzore për të mbuluar dhe realizuar të gjithë ngarkesën mësimore dhe kërkimore të programit Bachelor në “Kimi” (referuar Tabelave 1.1, 1.2 dhe 1.3 në RVB). Për të përmbushur të gjitha nevojat e mësimdhënies DK rezulton të ketë angazhuar staf me kohë të plotë edhe nga departamente të tjera të UV si ai i gjuhëve të huaja, biologjisë, matematikës, fizikës dhe shkencave kompjuterike. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|---|--|
| Standardi IV.3 | |
| Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | GVJ vlerëson se UV/DK ka të gjithë infrastrukturën e nevojshme e cila siguron zhvillimin e aktivitetit mësimor dhe kërkimor (evidenca III.19). Përveç godinave B dhe C të dedikuara për DK, në shërbim të mësimdhënies është edhe godina A (pjesë e UV apo departamenteve të tjera). Gjithashtu sipas gjetjeve të GVJ, DK disponon një numër të mjaftueshëm laboratorësh (referuar Tabelës 16 në RVB) me sipërfaqe të konsiderueshme brenda standarteve të kërkuara duke ruajtur raportin sipërfaqe (m ²)/student (për Departamentin e Kimisë). Raporti sipërfaqe (m²)/student në nivel universiteti rezulton 2.9 m²/student (referuar Tabelës 16 në RVB) kundrejt 5 m²/student që kërkon standardi⁶. Gjithsesi, bazuar në numrin e vogël të studentëve në DK (referuar Tabelës 21), GVJ konkludon se raporti sipërfaqe (m²)/student është brenda normave të standardit. |
| Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Mjediset mësimore të DK janë të pajisura me salla leksionesh, seminaresh dhe ambiente për laboratorët. Ambientet janë të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor. Gjetjet tona janë që këto mjedise kanë numër postesh të përcaktuar sipas numrit të studentëve të planifikuar (referuar Tabelës 16 në RVB). Megjithëse mjetet audio-vizuale nuk janë të instaluar në mjediset mësimore, personeli akademik është i pajisur videoprojektorë portabël. |
| Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e | DK përveç laboratorëve të vënë në dispozicion për zhvillimin e orëve laboratorike (referuar Tabelës 16, RVB) përdor edhe mjediset e Qendrës Kërkimore dhe Shkencore të Fakultetit të Shkencave Teknike. Gjatë vizitës “online” në Qendrën Kërkimore GVJ konstatoi |

⁶ Referuar takimeve “online” raporti është llogaritur në nivel institucioni.

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| kërkesave të moduleve, aftësimi teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | se kjo qendër disponon pajisje të mjaftueshme për zhvillimin e seancave laboratorike në përputhje me programin. | | | |
| Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron. | GVJ vlerëson se ambientet e DK janë të pajisura me kompjutera në të cilët janë të instaluar sistemet operative Windows si dhe paketat Microsoft Office shumë të nevojshme për vënien në përdorim nga studentët gjatë përpunimit të të dhënave laboratorike (ndërtimi i grafikëve, llogaritje të ndryshme të parametrave kimiko-fizikë). Për zhvillimin e modulit Teknologji Komunikimi dhe Informacioni (TIK) (evidenca III.24), DK përdor laboratorin e IT (referuar Tabelës 16 në RVB) i cili ka të instaluar në kompjutera e tij programet e duhura profesionale. | | | |
| Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. | GVJ konstatoi se programi i studimit Bachelor në “Kimi” nuk e ka pjesë të programit praktikën mësimore (pas përfundimit të studimeve 3-tre vjeçare) (evidencat I.5 dhe I.6). GVJ sqaron se kjo është në ngjashmëri me programet e tjera të studimit Bachelor në “Kimi”, p.sh. Bachelor në Kimi pranë Departamentit Kimi, Fakulteti i Shkencave të Natyrës/Universiteti i Tiranës. Praktikat mbulohen nga zhvillimi i punëve laboratorike për çdo lëndë gjatë viteve akademike. Gjithsesi, në përvojën tonë studentët kërkojnë vazhdimisht kryerjen e një praktike në institucione apo kompani të ndryshme. <i>Në këtë kontekst, GVJ sugjeron se UV/FSHT/DK duhet të bashkëpunojë me institucione dhe subjekte të tjera për zhvillimin e praktikave profesionale nga ana e studentëve.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| Standardi IV.4 | |
|---|---|
| Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Referuar RVB dhe vizitave “online”, GVJ shpreh mendimin se IAL/DK disponon bibliotekë mësimore me hapësira dhe kapacitete të mjaftueshme dhe është e hapur në orare të përshtatshme dhe paralel me oraret e mësimi. Konkretisht UV zotëron bibliotekën qendrore e cila gjendet në godinat A; B dhe C (evidenca III.25 edhe Tabela 16 në RVB). |
| Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore | Pjesë e bibliotekës është dhe literatura bazë dhe e këshilluar e programit të studimit. Referuar RVB, biblioteka e UV zotëron 35.000 tekste dhe 15.000 tituj në bibliotekat e godinave A, B dhe C (referuar Tabelës 16 në RVB). |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Tekstet mësimore janë në shqip dhe në gjuhë të huaj. Në veçanti, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore (referuar RVB) ka rritur, vitet e fundit, numrin e teksteve dhe vëllimeve në gjuhën shqipe dhe angleze (evidenca III.25). | | | |
| Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit. | E mbështetur nga MASR, IAL ka vënë në përdorim të stafit akademik dhe studentëve shërbimin e bibliotekës on-line "ULIBRARY" (referuar informacioneve në faqen zyrtare të IAL si edhe Tabelës 17 në RVB). Shërbimi është pa pagesë për studentët dhe personelin akademik. | | | |
| Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. | Bazuar në RVB, UV/DK disponon në bibliotekën e tij një numër të konsiderueshëm kompjuterash si edhe projektorë. Konkretisht 9 kompjutera në bibliotekën qendrore të godinës A dhe nga 4 kompjutera në secilën nga godinat B dhe C. Këto pajisje mund të shfrytëzohen pa kufizim nga ana e studentëve (evidenca III.23). | | | |
| Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit. | GVJ konstaton se gjatë viteve akademike 2016-2017, 2017-2018, 2018-2019, 2019-2020 (evidenca I.21), në kuadër të plan-buxheteve vjetore përkatëse DK ka planifikuar dhe realizuar pasurimin me libra në fondin e bibliotekës, tregues ky i përpjekjeve për të rritur cilësinë e procesit mësimor dhe të jetës studentore. | | | |
| Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Referuar RVB, biblioteka në godinat A, B dhe C janë të hapura në oraret 08:00-20:00 dhe 08:00-16:00 respektivisht (e hënë-e premte). Oraret janë të përshtatshme me oraret e mësimimit dhe vihen në dispozicion të studentëve (evidenca III.23). | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Në bazë të gjetjeve tona, IAL/DK ka vënë në funksionim të plotë sekretarinë mësimore e cila zotëron në formë të shkruar, regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin me të dhënat akademike, regjistrin e lëshimit të diplomave (evidencat III.46, III.47, III.48). E gjithë procedura është në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 dhe nenet përkatëse të sanksionuara në Statutin e IAL. Sekretaria mësimore arkivon gjithashtu, dosjet e regjistrimit të studentëve, procesverbalet e notave, dosjet e diplomimit. Në funksion të menaxhimit të informacionit UV zotëron sistemin elektronik të komunikimit të brendshëm. |

| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|--|
| <p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrative dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> | <p>Gjatë takimeve “online” Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore vuri në dispozicion të GVJ dy dosje, personel akademik të brendshëm dhe personel akademik të ftuar të Departamentit Kimi të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore (UV). Dosjet personale të personelit akademik dhe ndihmës-akademik ishin të plota dhe përmbanin CV, kontratat e punës, diplomat e noterizuara etj. Referuar RVB (evidencat IV.11 dhe IV.12), kjo drejtori administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik si dhe personelit administrativ.</p> | | | |
| <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>GVJ vëren se UV/DK ka infrastrukturën e nevojshme e cila siguron një sistem menaxhimi të dedikuar dhe konfidencial për personelin akademik, ndihmës-akademik, personelin administrativ dhe studentët (evidenca III.22). Informacionet personale administrohen në përputhje me Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. Menaxhimi i informacionit dhe dokumentacionit realizohet nëpërmjet zyrës së Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore.</p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p> | <p>GVJ konstaton se personeli akademik komunikon në mënyrë të rregullt me studentët nëpërmjet platformës e-learning e integruar në sistemin e menaxhimit të informacionit UMS (evidenca III.27). Nëpërmjet kësaj platforme personeli akademik ju ofron studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me aktivitetin mësimor. Studentët e aksesojnë informacionin nëpërmjet llogarive të tyre. Në të njëjtën mënyrë sigurohen edhe informacionet nga sekretaria mësimore dhe administrata.</p> | | | |
| <p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p> | <p>Referuar RVB (evidenca IV.16) dhe faqes zyrtare të UV, brenda sistemit të menaxhimit UMS është instaluar llogaria “Menaxhosh” e cila mundëson raportimin e të gjithë aktivitetit akademik semestral dhe vjetor të FSHT. Të gjitha problematikat adresohen në këtë llogari. Dekanati realizon përgjigjen e problematikave nëpërmjet rubrikës “Shërbime”.</p> | | | |
| <p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p> | <p>Referuar faqes zyrtare të internetit të UV (https://univlora.edu.al/), DK ka vënë në dispozicion të studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit Bachelor në “Kimi”. Informacioni dhe aktivitetet lidhur me programin përditësohen rregullisht. Informacionet në faqen zyrtare janë në gjuhën shqipe dhe atë angleze.</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|---|
| Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Sipas gjetjeve në RVB, tarifat e shkollimit miratohen çdo vit nga IAL për çdo cikël studimi (evidenca IV.17). Këto tarifa nuk e kapërcejnë tavanin e vendosur nga VKM Nr. 638 dt. 22.07.2015 e ndryshuar. Në kuadër të raportit vjetor, IAL harton periodikisht edhe raportin financiar për mbarëvajtjen e programit për ciklin e plotë të studimit (evidenca J). |
| Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij. | Referuar RVB, FSHT/DK harton çdo vit plan-buxhetin e cili përfshin pagesat e personelit akademik (PAE, PAK), personelin akademik të jashtëm ose të ftuar, personelin ndihmës-akademik, personelin administrativ, investimet për laboratorët mesimorë dhe kërkimorë, shpenzime për pasurimin e fondit të bibliotekës, kërkesat për pajisjen me kompjutera dhe videoprojektorë. Në mbështetje të rritjes profesionale të personelit akademik DK planifikon në plan-buxhet mbështetje financiare për konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare (evidencat I.21 dhe IV.18). <i>GVJ shpreh mendimin se DK duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të siguruar grante të huaja në formën e projekteve të cilat mundësojnë pasurimin e laboratorëve didaktikë dhe kërkimorë, pasurimin e fondit të bibliotekës me literaturë të huaj dhe vënien e tyre në funksion të plotë të realizimit dhe përmisimit të programit të studimit.</i> |
| Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. | GVJ konstaton se auditimet e UV nga Ministrisa e Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit janë periodike. UV kryen në mënyrë të përvitshme auditin e brendshëm i cili realizohet nëpërmjet Sektorit të Auditit të Brendshëm (referuar organigramës të UV). Raportet financiare përmbajnë informacione të detajuara lidhur me të ardhurat dhe tarifat e shkollimit dhe janë të certifikuara edhe nga Dega e Thesarit Vlorë (evidencat III.20, IV.19, IV.21). |
| Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. | GVJ vëren se UV/DK harton në mënyrë periodike plan-buxhete 3 (tre) vjeçare i cili përmban analiza financiare të hollësishme duke përfshirë të gjithë zërat e nevojshëm për realizimin e programit të studimit. Përveç plan-buxheteve 3 (tre) vjeçare UV/DK realizon edhe analizat financiare vjetore dhe identifikon/planifikon ndërhyrjet e nevojshme për ecurinë normale të programit (evidencat IV.20 dhe 4.26). |
| Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. | GVJ konstaton se UV/DK si IAL publike siguron mbështetjen financiare kryesisht nëpërmjet grantit të përcjellë nga Ministria e Arsimit, Rinisë Sportit. Të ardhurat totale përgjatë viteve akademike 2016-2017--2019-2020, përfshirë të ardhurat nga pushteti qendror/vendor dhe tarifat e shkollimit rezultojnë në rritje (referuar Tabelës 18 në RVB), përkatësisht 483,697,327 (2016-2017) dhe 528,575,140 (2019-2020). Kjo dëshmon se IAL ka qëndrueshmeri financiare. <i>DK në veçanti ka një numër të vogël studentësh i cili kufizon kapacitetet financiare të departamentit (referuar Tabelës 21). GVJ</i> |

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 42

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>sugjeron se DK duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të rritur numrin e studentëve në programin e studimit dhe duhet të shfrytëzojë të gjitha burimet e mundshme financiare psh. përfitime financiare nga projektet ndërkombëtare, shërbimet për të tretët etj.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

| | | | | |
|--|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| Standardi V.1 | |
|---|--|
| Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Sipas gjetjeve në RVB (evidencat II.7 dhe I.2), FSHTN/DK ka hartuar dhe zbaton të gjitha procedurat e nevojshme për një ecuri normale dhe të plotë të ciklit akademik. Procedurat dhe rregulloret janë hartuar dhe bazuar në ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 dhe Aktet nënligjore të tij. Të gjitha hapat që përfshijnë regjistrimin e studentëve, transferimin (referuar Tabelës 21 në RVB) (aty ku ka), ndjekjen e programit deri në diplomim janë sanksionuar në Statutin e UV dhe rregulloren e DK (evidencat A, II.7 dhe I). |
| Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | GVJ konstaton se FSHT/DK zbaton politikat dhe procedura të barabarta për të gjithë studentët (evidenca I.2). Në këtë aspekt GVJ vëren se studentët (takimet “online”) informohen rregullisht nga Këshilltari Akademik (staf akademik i brendshëm). Ata kanë llogaritë e tyre personale në sistemin elektronik të UMS dhe kanë të drejtën e ankimimit për rezultatin e provimit. Gjithashtu, studentëve u jepet vazhdimisht mundësia për të ndjekur programe të mobiliteteve. <i>Në këtë aspekt, GVJ vëren se megjithëse studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme nga personeli akademik dhe Përgjegjësi i Departamentit të Kimisë për programet e mobilitetit, rezulton se nuk ka asnjë pjesëmarrje nga ana e studentëve në këto programe (referuar Tabelës 20 në RVB). GVJ sugjeron se Departamenti i Kimisë duhet të zbatojë politika më nxitëse në këtë drejtim për rekrutimin e studentëve në programet e mobilitetit.</i> |
| Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Bazuar në takimet “online” me studentët e DK, theksojmë se studentët kontaktin e parë për informacionet lidhur me programin e studimit, regjistrimin, transferimin e studentëve, diplomimin etj. e marrin nëpërmjet faqes zyrtare të UV (https://univlora.edu.al/). Informacione më të detajuara rezultojnë të sigurohen nga afishimet në sekretarinë mësimore dhe fletëpalosjet apo guidat e ndryshme (evidenca V.2). |
| Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve. | Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve vijnë në përgjigje të kërkësës së MASR. DK (referuar RVB, evidenca I.17) harton kriteret për pranim një vit në avancë dhe përfshin në kuotat e parashikuara edhe kandidatë nga trojet dhe shtresat e marginalizuara. |
| Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën | GVJ vëren se hartimi i kriterëve të përgjithshme dhe specifike të Programit të Studimit Bachelor në “Kimi” janë në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015468, VKM-në përkatëse (kriteri i notës mesatare për pranimin e kandidatëve) dhe maturën shtetërore. Sipas RVB në kuotat e |

| | | | |
|---|--|------------------------------|------------------------------|
| shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj. | pranimit përfshihen jo vetëm kandidatë brenda vendit por edhe nga trojet si edhe shtetas të huaj (evidenca I.16). | | |
| Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | UV/FSHT referuar RVB, dëshmon se çdo fillim viti akademik organizon ditët e hapura “Info Day” për gjimnazistët dhe prindërit e interesuar (evidencat V.5 dhe V.6). Në këto takime marrin pjesë pedagogë dhe studentë nga degë të ndryshme. Në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të Edukimit këto takime zhvillohen edhe në qytetet të tjera si Fier, Berat, Lushnje dhe Sarandë (evidenca V.6). | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht |
| | | | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|---|
| Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Mbështetur në RVB dhe takimet “on-line” me studentët si dhe informacionin e publikuar në website-in https://univlora.edu.al/departamenti-i-kimise/ rezulton se DK vë në dispozicion të studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kriteret dhe procedurat akademike. Këtu përfshihen planet mësimore (evidenca I.5) të viteve të fundit, numri i krediteve i nevojshëm për të kaluar nga njeri vit akademik në tjetrin, syllabuset e lëndëve të përditësuara etj. |
| Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme. | GVJ vëren se në përputhje me Rregulloren e Departamentit (evidenca I.2) dhe Statutin e UV (evidenca A), DK ngre komisione të ekuivalentimit të lëndëve për të realizuar të gjitha procedurat e nevojshme të transferimit të studimeve për studentët që kanë kualifikime nga studimet e mëparshme. GVJ vëren (referuar Tabelës 21, RVB) se gjatë vitit akademik 2016-2017 ka patur një student të transferuar, ndërsa gjatë viteve akademike 2017-2018, 2019-2020, 2020-2021 nuk ka asnjë student të transferuar. Këshillohet të bëhen përpjekje për rritjen e numrit të studentëve të transferuar e cila mundëson edhe rritjen numrit të studentëve në programin e studimit bachelor në “Kimi”. |
| Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Informacionet në lidhje me procedurat e vlerësimit të lëndëve jepen në mënyrë të plotë në syllabuset e lëndëve (referuar Tabelave 10.11 dhe 14, RVB). Nëpërmjet syllabusese studentët mund të informohen në lidhje me kreditet e lëndëve, mënyrën e vlerësimit, provim ose vlerësim i vazhduar, temat e leksioneve apo të punëve laboratorike aty ku ka. |
| Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Bazuar në Rregulloren e UV-se (evidenca C), të DK (evidenca I.2) dhe Rregulloren e programit të studimit (evidenca II.1) rezulton se studentët informohen në lidhje me kriteret dhe procedurat e diplomimit. Gjetje të tilla u konstatuan edhe gjatë takimeve “on-line” me studentët. Studentët |

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 45

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | kanë kontakte të rregullta me këshilltarin akademik dhe me sekretarinë mësimore nëpërmjet të cilëve marrin informacion edhe për punimin e diplomës. | | | |
| Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | Referuar RVB dhe takimeve me studentët, GVJ konstaton se në periudhën Mars-Maj, UV/DK në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore dhe strukturat e brendshme të IAL (Sektori i Këshillimit dhe Karrierës dhe Alumni-t) organizon ditët të hapura për publikun “Info Day” (evidencat V.5, V.6 dhe V.7). Në këto takime shpërnahen broshura me informacione të detajuara për çdo program studimi. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. | GVJ vëren se strukturat e UV/DK (evidenca I.2) si sekretaritë mësimore, këshilltari akademik, koordinatori për marrëdhëniet me studentët, specialisti për shërbim ndaj studentit vihen në dispozicion të studentëve për t’i informuar ata për programin e studimit, syllabuset, zhvillimin e punëve laboratorike etj. Në funksion të informacionit për studentët është edhe faqja zyrtare e UV/DK https://univlori.edu.al/departamenti-i-kimise/programet-e-studimit-kimi/ Gjetje të tilla u konstatuan edhe gjatë takimeve me studentët. |
| Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Referuar, Rregullores të programit Bachelor në “Kimi” (evidenca II.1), rezultojnë se UV/DK vë në dispozicion të studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm për programin që ofron. Në ndihmë të informacionit mbi programin e studimit vjen edhe faqja zyrtare e UV/DK si dhe sistemi informativ UVMS. Bashkëbisedimet me studentët gjatë takimeve “online” konfirmuan këto gjetje. |
| Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës. | Bazuar në RVB (evidencat V.9 dhe V.10), IAL deklaron se po punon për mbështetjen institucionale të studentëve për orientimin drejt karrierës dhe tregut të punës dhe ka marrë (IAL) pjesë në Panairin e Punës ku studentët mund të njihen me informacione për punësim dhe punëdhënës të ardhshëm të mundshëm. <i>Gjatë takimeve “online” u deklarua se ka një studim të tregut të punës, gjithsesi në evidencat në nivel institucional apo evidencat mbështetëse në tërësi nuk rezultojnë të ketë një raport të tillë. Në RVB jepet link-u i pyetësorit⁷ mbi punësimin e studentëve por nuk ka asnjë evidencë mbështetëse për këto të dhëna (“database”, numri i</i> |

⁷<https://docs.google.com/forms/d/1WOna7amzitpxhouUSWhmaJQuGvezK2914Mt94YIJZ5Y/edit?ts=5e3969a2>

| | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|
| | <p><i>studentëve që kanë marrë pjesë në pyetësor, emrat e tyre, viti kur janë diplomuar etj.)</i></p> <p><i>Në vijim të rekomandimeve të dhëna tek standardet, I.3 Kriteri 2 dhe II.4 kriteri 9, FSHT dhe DK në veçanti duhet të realizojë një studim të tregut të punës e cila mund të përbëjë një bazë për përcaktimin e kuotave të pranimit për këtë program studimi. Gjithashtu në kuadër të strategjisë afatgjatë programi i studimit duhet të përcaktojë edhe përshtatshmërinë me kërkesat e tregut.</i></p> | | |
| <p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> | <p>Gjetjet e GVJ janë se studentët e DK nëpërmjet faqes zyrtare të UV /DK (https://univlora.edu.al/departamenti-i-kimise/programet-e-studimit-kimi/), sistemit të menaxhimit të informacionit UVMS (evidenca III.27), sekretarisë mësimore si dhe stendave të informacionit marrin informacion të përditësuar dhe të gjerë mbi organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor.</p> | | |
| <p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p> | <p>Referuar RVB, GVJ vëren se DK nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit UVMS Univlora, u jep studentëve mundësinë të kenë akses mbi informacione të ndryshme në lidhje me programin e studimit (evidenca III.27). Studentët janë të pajisur me kode personale nëpërmjet të cilëve mund të marrin informacion për lëndët e tyre, pikët e provimeve, notat etj.</p> | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> |
| | | | <p>X</p> |

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p> | <p>Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 si dhe Statutit të IAL (nenet 78, 79) ku sanksionohet ruajtja e dokumentacioni mësimor dhe baza e të dhënave të studentëve, GVJ konstaton se DK nëpërmjet sekretarisë mësimore disponon në formë të shkruar, regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e të dhënave akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave (evidencat IV.46, IV.47, IV.48).</p> <p>Gjithashtu referuar RVB dhe takimeve “online” me sekretarinë mësimore rezulton se kjo sekretari arkivon dosjet e regjistrimit të studentëve, dosjet e transferimeve dhe të programeve të dyta të studimit etj.</p> <p>Në sekretarinë mësimore arkivohen gjithashtu edhe largimet e studentëve para përfundimit të programit si edhe studentët të cilët nuk e përfundojnë me sukses programin e studimit, studentët që çregjistrohen etj. Në arkivim përfshihen edhe dhe procesverbalet e provimeve të studentëve.</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> | |
| <p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p> | |

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p> | <p>Referuar RVB (evidenca III.21) dhe takimeve “online” me sektorin e IT, u dëshmuar se sistemi i menaxhimit të informacionit UVMS, mundëson përveç të tjerave një platformë dixhitale e cila u ofron studentëve dhe stafit të kenë informacion të plotë dhe transparent të procesit mësimor. Nëpërmjet kësaj platforme sigurohen statistika të plota të numrit të studentëve përgjatë vitit akademik, përfshirë këtu edhe studentët që nuk arrijnë ta përfundojnë vitin akademik.</p> | | | |
| <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p> | <p>Bazuar në RVB, IAL ka hartuar Raportin Vjetor (evidenca I) ku janë përfshirë veprimtaritë mësimore dhe shkencore, si dhe ecuria e programeve të studimit. Pjesë e këtij raporti është edhe raporti i DK i cili përfshin informacion të detajuar mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre. <i>Në këtë kontekst, GVJ vëren se gjurmimi i punësimit të studentëve është bërë nga DK, gjithsesi ai duhet të jetë periodik, i vazhduar dhe i shoqëruar me masat e duhura për të përmisuar cilësisë e punësimit të studentëve.</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

| <p>Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</p> | |
|--|--|
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p> | <p>Referuar Tabëlës 24 dhe RVB, IAL/DK në përputhje me LAL si dhe Statutin e UV (evidenca A), neni 73, pika ç, angazhon studentët në organet vendimmarrëse. Konkretisht, Senati Akademik i UV ka dy anëtarë përfaqësues të studentëve. Studentët janë të angazhuar në Këshillin Studentor, në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p> | <p>Referuar Tabelës 24, Kristi Dukaj përfaqësuese e studentëve në Departamentin e Kimisë është angazhuar, gjatë periudhës Mars-Prill 2019, në fushatën e promovimit të cilësisë, në kuadër të plotësimit të pyetësorëve të sondazhit të studentëve.</p> <p>Studentët kanë përfaqësues në Bordin e Adminisrimit dhe Komisionet e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë për çdo njësi Kryesore dhe në nivel Institucional.</p> <p>Referuar takimeve “online” me studentët, GVJ vëren se studentët kanë gjithastu, Komisionin Institucional Zgjedhor të Studentëve (KIZS) i cili është ngritur me vetëkandidim të studentëve, nëpërmjet të cilit studentët kanë krijuar këshillat studentore në nivel institucioni dhe njësie kryesore.</p> <p>Bazuar në RVB, studentët Elena Velaj, Marina Alikaj dhe Kristi Dukaj janë përfshirë edhe në Grupet e Vlerësimit të Brendshëm (evidencat 00, V.18, V.19). Përsa më sipër, GVJ konkludon se studentët e</p> |

| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | UV/FSHT/DK janë të përfshirë në struktura të rëndësishme vendimmarrëse të jetës akademike. | | | |
| Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme. | Në përputhje me VKM Nr.41, dt.24.01.2018, pika 2.1/d, rezulton se DK ka parashikuar në Planin Mësimor (evidenca I.5) dhe Orarin Semestral (evidenca II.10) se studenti duhet të ketë jo më shumë se 20-25 orë/javë në auditor. Gjithashtu, për studentët që ri-fillojnë studimet pas një periudhe shkëputje, DK ka përcaktuar në Rregulloren e tij (evidenca I.2) dhe Rregulloren e programit mësimor (evidenca II.1) të gjitha procedurat përkatëse për njohjen e arritjeve akademike të mëparshme. Këtu përfshihen edhe studentët e regjistruar të cilët janë diplomuar në një program të mëparshëm. | | | |
| Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to. | Referuar takimeve “online” si dhe gjetjeve në RVB (evidencat II.1 dhe III.16), rezulton se FSHT/DK ka krijuar mekanizmat e duhur të komunikimit për përfshirjen e mendimit të studentëve në proceset e hartimit, rishikimit apo përmisimit të programit të studimit. Konkretisht, Këshilltari ose Koordinatori akademik realizon në mënyrë të rregullt takime me studentët. Studentët mund të japin mendime për programin e studimit, lëndët apo përmisimin e syllabuseve gjatë plotësimit të pyetësorëve të zhvilluar nga UV. Gjithashtu, Këshillat Studentorë mund të japin mendimet e tyre me shkrim për çështje të ndryshme lidhur me përmisimin e programit. | | | |
| Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | GVJ konstaton, se procesi i vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë këtu edhe mundësinë e ankimimit të rezultatit nga ana e studentëve është i sanksionuar në githa rregulloret e IAL (Rregulloren e universitetit, departamentit dhe të programit të studimit, evidencat C, I.2 dhe II.1). Referuar RVB dhe takimeve me studentët, studenti mund të kërkojë ankimim për rezultatin e provimit. Ankimimi i dorëzohet me shkrim Përgjegjësit të Departamentit i cili vë në dijeni Dekanin. Ky i fundit ngre komisionin <i>ad hoc</i> i cili verifikon pretendimet e studentit/tes. Përsa më sipër procedura e detajuar është raportuar në RVB. Të gjitha hapat e procesit janë përshkruar në procesverbalet përkatëse. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve,

Kontaktin fillestar për të siguruar informacionin paraprak studentët e IAL e kanë me faqen zyrtare të UV/DK ku mund të gjejnë edhe

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. | Ilogarinë e facebook-ut të UV. Referuar RVB (evidenca V.2) dhe takimeve me studentët, GVJ vëren se në shërbim të informimit të studentëve është ngritur sekretaria mësimore e cila kryen të gjitha shërbimet akademike dhe zyra e studentit e cila mundëson shërbimin e bursave. | | | |
| Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | Në funksion të informimit dhe këshillimit të studentëve është vënë edhe shërbimi i Këshilltarit ose Koordinatorit akademik (evidenca I.2). Ky i fundit asiston dhe këshillon intesinsivisht, në veçanti, studentët e vitit të parë. Studentëve të vitit të parë u jepet gjithashtu, mundësia të takohen me studentët viteve të dyta apo të treta për informacione shtesë, orientime etj. Broshurat apo fletëpalosjet informuese të hartuara nga DK janë gjithashtu në shërbim të informimit të studentëve. | | | |
| Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Referuar organigramës së IAL (evidenca I.9), UV ka ngritur në shërbim të këshillimit dhe karrierës të studentëve, Sektorin e Këshillit të Karrierës ALUMNI dhe aktiviteteve kulturore-sportive. Referuar takimeve me studentët ky sektor informon studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike lidhur me kompletimin e procesit mësimor, mundësitë e punësimit, zhvillimin e praktikës etj. Informacionet në lidhje me zyrën e ALUMNI-it gjenden në faqen zyrtare https://univlora.edu.al/alumni/ . Në këtë faqe studentët e ALUMNI-it mund të njihen edhe me database-in e tyre si dhe formularin e regjistrimit. GVJ konstaton se kjo zyrë, referuar RVB, ndjek në mënyrë të rregullt karrierën profesionale të alumnëve të saj nëpërmjet evidencave të mbajtura gjatë aktiviteteve periodike (referuar Tabelës 23 në RVB). | | | |
| Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | Gjithashtu, në funksion të mundësive të punësimit, Sektori i Këshillit të Karrierës ALUMNI ka organizuar “Panairin e punës”, “Orientim në tregun e punës”, “Open Day UV” etj. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

| Standardi VI.1 | |
|---|---|
| Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> | <p>Sipas RVB, IAL në zbatim të LAL Nr. 80/2015 pika 1, ka ngritur struktura në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Këto struktura IAL, i ka të parashikuara në Statut (Kreu VIII, neni 81- 83, evidenca A). Gjithashtu, GVJ konstanton se IAL ka parashikuar në Statutin e vet (evidenca A), ngritjen e Komisioneve të Përherëshme të Sigurimit të Cilësisë në nivel Institucioni dhe Njësie Kryesore.</p> <p>Bazuar në evidencat mbështetëse të RVB, GVJ konstanton se IAL ka hartuar formularë në formën e pyetësorëve për studentët në lidhje me cilësinë e mësimdhënies dhe performancën e personelit akademik, ndihmës akademik etj. GVJ vlerëson se IAL ka ndërmarrë të gjitha hapat për të siguruar strukturat dhe procedurat e nevojshme për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (Vendimet e Senatit Nr. 51 dhe 52, evidencat VI.2 dhe III.6).</p> <p><i>Gjatë vizitës “online” u deklarua se studentët marrim pjesë në anketime të ndryshme duke ju përgjigjur formularëve përkatës në lidhje me cilësinë e mësimdhënies dhe performancën e stafit. Evidencat III.9 dhe III.11 (2017-2018) në RVB japin të dhëna dhe analiza për procedurën e anketimit dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Gjithsesi GVJ konstaton se nuk ka të dhëna apo analiza statistikore të plota ndër vite (4-5 vjeçare) se sa studentë kanë marrë pjesë në anketime lidhur me cilësinë e mësimdhënies, performancën e personelit akademik, ndihmës-akademik, shërbimi ndaj studentëve etj.</i></p> <p><i>Në këtë kontekst, nuk rezulton të jenë paraqitur rezultatet e plota të këtyre pyetësorëve dhe se cilat kanë qenë masat e ndërmarrja bazuar në rezultatet e vetvlerësimit. GVJ referuar RVB, konstanton se evidenca VI.7 pasqyron planin e masave për analizën e pyetësorëve por vetëm për vitin akademik 2018-2019. Nevojitet një tablo më e qartë e të gjitha problematikave të konstatuara.</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p> | <p>Në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë UV ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (NJSBCVI) e cila është vënë në zbatim të strategjisë së IAL dhe përmisimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies (evidencat VI.2 dhe III.6). Njësia ka në përbërjen e saj edhe studentë.</p> <p><i>Në RVB deklarohet se është parashikuar edhe ngritja e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në nivel fakulteti apo departamenti (referuar RVB dhe Statutit-evidenca A). GVJ nuk gjeti asnjë evidencë për ngritjen ose funksionimin (në rast se janë formuar) e këtyre njësive. GVJ sugjeron se është e nevojshme ngritja</i></p> |

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 51

| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>e NJSBC të paktën në nivel fakulteti, ose në të kundërt IAL mund/duhet të hartojë dhe të vërë në zbatim Manualin e Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik. Në këtë manual duhet të përshkruhen qartë të gjitha procedurat, shkallët dhe elementët e vlerësimit.</i> | | | |
| Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. | Në funksion të sigurimit të jashtëm të cilësisë, UV ka realizuar me sukses vlerësimin e jashtëm institucional. Vlerësimi i jashtëm është kryer nga kjo IAL me qëllim vlerësimin e shkallës së përmbushjes së Standardeve Shqiptare Shtetërore të Cilësisë. Proçesi i Akreditimit të Parë Institucional, IAL e ka përfunduar me një vlerësim pozitiv me një kohëzgjatje prej 3 (tre) vite akademike (evidenca II.6). Ky vlerësim dëshmon se UV zotëron dhe përdor instrumentet e duhura për përmbushjen e standardeve, sigurimin dhe përmisimin e cilësisë. | | | |
| Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit. | Në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, IAL ka ngritur Njësinë e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë (evidencat VI.2 dhe III.6). Gjithashtu, IAL ka parashikuar në Statutin (evidenca A) dhe Rregulloren (evidenca C) e saj procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen. <i>GVJ sugjeron se hartimi i Manualit të Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik i sugjeruar tek Kriteri 2, vlen edhe për Kriterin 5. Në elementët e vlerësimit të performancës përfshihet edhe përmirësimi i programeve dhe kurrikulave nga ana e personelit akademik.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

| | |
|---|--|
| Standardi VI.2 | |
| Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë. | Referuar RVB, në funksion të monitorimit, shqyrtimit dhe rishikimit të programeve të ciklit të parë dhe të dytë, UV ka ngritur Drejtorinë e Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë. Këtu përfshihet edhe Sektori i Kurrikulave dhe Shërbimit ndaj Studentit (evidenca I.9). Në shërbim të përmisimit të programeve funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (evidenca III.30). IAL ka parashikuar edhe ngritjen e Komisioneve të Sigurimit të Cilësisë së Brendshme (në nivel fakulteti). <i>Në vijim të sugjerimit tonë (Standardi IV.2, kriteri 3), në funksion të përmisimit apo rishikimit të vazhdueshëm të programit, DK duhet të pasurojë punët laboratorike me tematika të reja për lëndët Kimi Fizike. Gjithashtu, në kuadër të ndryshimeve në masën 20%, DK mund të zgjerojë një nga lëndët Kimi Fizike I dhe Kimi Fizike II në Kimi Fizike dhe Koloidale duke përfshirë kështu edhe njohuritë e</i> |

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 52

| | |
|--|--|
| | <p><i>lëndës e Kimisë Koloidale brenda programit (referuar Tabelave 10 dhe 11 në RVB).</i></p> <p><i>Në të kundërt, në vijim të rekomandimit të dhëne tek standardi II.4 kriteri 3 mund të ri-shperndarhen kreditet (ulje e krediteve ne disa lëndë) duke mbajtur lëndët Kimi Fizike I dhe Kimi Fizike II dhe duke shtuar lëndë Kimi Koloidale (referuar Tabelave 10 dhe 11 në RVB).</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p> | <p>GVJ vëren se UV/DK ka vënë në zbatim mekanizma dhe procedura të dokumentuara për shqyrtimin apo mbikëqyrjen e programeve të studimeve të ciklit të parë. Në këtë kontekst, IAL ka hartuar raportin vjetor në nivel institucioni dhe departamenti ku përfshihen analizat e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor (evidencat J dhe I.35). DK vë në zbatim procedurat për ndryshime në programin e studimit Bachelor në “Kimi” referuar LAL, VKM dhe Udhëzimeve apo Urdhërave përkatëse.</p> <p>Gjithashtu, IAL ka hartuar pyetësonin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. Këta pyetësorë përcillen tek studentët në fund të çdo semestri dhe para sezonit të provimeve (evidenca VI.2). DK në përfundim të pyetësorit harton dhe zbaton plan masash për përmirësimin e mëtejshëm të programeve mësimore.</p> <p><i>GVJ konstanton, referuar RVB se është paraqitur plani i masave për vitin 2018-2019 (evidencat I.24, I.35, III.6, VI.8). GVJ nuk gjeti asnjë evidencë në lidhje me pyetësorët apo analizat e tyre për vite të tjera akademike. GVJ sugjeron se pyetësorët dhe analizat përkatëse nuk duhet të jenë sporadike.</i></p> <p><i>Gjithashtu, Evidenca, footnote 641, Publikimi i Analizës së pyetësorëve në website-in e UV: https://univlora.edu.al/2019/12/11/publikimi-i-raportit-te-analizese-se-pyetesoreve-te-studenteve/ rezulton jo aktive (page can not be found)</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p> | <p>Në kuadër të hartimit të raportit vjetor në nivel institucional, GVJ vëren se, DK ka hartuar analizën vjetore e cila përmban informacione të detajuara në lidhje me numrin e përvitshëm të studentëve frekuentues, funksionimin e Këshillimit akademik, numrin e të diplomuarve, kalueshmërinë e studentëve, pyetësorët, ankesat e protokolluara të studentëve etj (evidenca I.24). Raporti/analiza vihet në funksion të vlerësimit dhe mbarëvajtjes së programeve të studimeve.</p> <p><i>Në RVB deklarohet gjithashtu se NJSBCVI ka hartuar anketimin e studentëve për të dytin vit radhazi. Gjithashtu, referuar RVB janë bërë edhe analizat përkatëse për të dyja vitet. RVB, vëren se në evidencat mbështetëse jepet analiza vetëm e një vit akademik (evidenca I.24).</i></p> <p><i>Referuar RVB, UV në zbatim të statutit të tij (evidenca A) realizon çdo vit akademik vlerësimin e performancës së personelit akademik</i></p> |

| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>dhe ndihmësakademik (evidenca I.24). Ky vlerësim kryhet nëpërmjet plotësimin të pyetësorëve nga studentët për një lëndë të caktuar.</i> | | | |
| | <i>GVJ rekomandon se vlerësimi i performancës së personelit akademik dhe ndihmësakademik nuk duhet të bazohet vetëm në një element vlerësimi (pyetësorët e studentëve).</i> | | | |
| Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | Referuar RVB, UV/FSHT dhe DK ka vënë në zbatim Procedurën e Analizës dhe Vlerësimin të Pyetësorëve të Studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për Lëndët e çdo Programi Studimi. Në këtë kontekst, NJSBCVI ka përpiluar Raportin e Analizës, propozimet dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e cilësisë të programeve dhe mësimdhënies (evidencat L dhe VI.8). | | | |
| Kriteri 5. Raportet e vlerësimin duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimin dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë. | <i>Në vijim të vlerësimin tonë (Standardi VI.1, kriteri I) si dhe bazuar në evidencat L dhe VI.8 (referuar RVB), ku pasqyrohet raporti mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2018-2019 dhe analiza e rezultateve të pyetësorit (Mbledhje Departamenti), GVJ konstaton se nuk ka të dhëna të plota të rezultateve të pyetësorëve. GVJ sugjeron se DK duhet të pasqyrojë raporte të përvitshme në lidhje me rezultatet e pyetësorëve.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

| | |
|---|---|
| Standardi VI.3 | |
| Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike. | Në RVB deklarohet se vlerësimi i brendshëm i programit të studimit është kryer në mënyrë periodike nga DK (evidenca VI.5). Në vlerësimin e brendshëm përfshihet edhe performanca e stafit akademik nëpërmjet sistemit të vlerësimin nga studentët (anketimeve). Vlerësimi i brendshëm i realizuar në nivel departamenti përfshihet në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike. <i>GVJ vëren se nuk ka njësi të sigurimit të brendshëm në nivel fakulteti e cila të jetë në funksion të plotë edhe të vlerësimin të brendshëm të programit të studimit. Përsa më sipër vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet nga vetë DK (evidenca VI.5).</i> |
| Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimin, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me | GVJ konstaton se për kryerjen e vlerësimin të programit të studimit DK ka përdorur edhe Raportin e Vetëvlerësimin Institucional 2017 (evidenca II.6). Ky i fundit është realizuar në kuadër të akreditimit |

| | |
|--|--|
| <p>natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p> | <p>institucional. Informacioni i raportit të vetëvlerësimit është përdorur edhe nga NJSBCVI.</p> <p>Në RVB deklarohet se mënyrat e vlerësimit në DK janë nëpërmjet vlerësimit të pyetësoreve të stafit akademik nga ana e studentëve për çdo lëndë (evidencat L dhe K), nëpërmjet dëgjimit të shpjegimit të lëndëve nga ana e Përgjegjës të Departamentit etj.</p> <p><i>Në këtë kuadër, GVJ vëren se për kryrjen e vlerësimit periodik mungojnë instrumentat, mekanizmat apo procedurat e plota të cilat mund të arrihen me hartimin e një manuali të përformancës dhe të cilësisë. Konkretisht në vlerësimin nga ana e Përgjegjës të Departamentit apo vlerësimin e pyetësorëve nuk thuhet se sa peshë zënë këto vlerësime në vlerësimin total apo të përgjithshëm.</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p> | <p>Në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes dhe cilësisë së programit të studimit, GVJ vëren (referuar RVB) se çdo fillim viti akademik Përgjegjësi i Departamenti kontrollon dhe vlerëson përbajtjen e Kurrikulave, syllabuseve pas diskutimeve me personelin akademik (referuar Tabelave 10 dhe 11 në RVB).</p> <p>Gjithashtu, në funksion të mbarëvajtjes dhe cilësisë së programit, DK në harton analizën vjetore (evidencat L dhe K) dhe përfshin në të elementët matës të rëndësishëm siç janë, plotësimi i standardeve të ambienteve dhe didaktikës laboratorike, konkluzionet e pyetësorit të studentëve, plotësimin e standardeve të stafit akademik, kalueshmërinë dhe cilësinë semestrale etj.</p> <p><i>Bazuar në takimet “online” si dhe referuar RVB* (shpërndarja e ngarkesës, Tabela 12 në RVB), GVJ sugjeron se me qëllim mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit është i nevojshëm edhe profilizimi i stafit që angazhohet me kohë të plotë në realizimin e programit.</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p> | <p>Referuar RVB, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit IAL përdor disa metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi.</p> <p>Këtu mund të përmendim, informacionin e përpunuar prej Sektorit të Këshillimit të Studentëve dhe Alumni-it (https://univlori.edu.al/alumni), realizimin e pyetësorëve për ish-studentët prej nga merret informacion në lidhje me punësimin e studentëve dhe sektoret ku ata janë punësuar etj.</p> <p>Në RVB raportohen gjithashtu, në kuadër të vlerësimit, edhe kontakte formale dhe joformale me drejtues të institucioneve të ndryshëm (evidenca II.6), si Drejtoria e Fabrikës Norga, Drejtues Tec Vlorë, Drejtoria DAR Vlorë etj. Këto takime janë vënë në funksion të njohjes me kërkesat e tregut të punës dhe pasqyrimin e tyre në kurrikulat mësimore.</p> <p>GVJ shpreh mendimin se DK ka arritur të përdorë mjetueshëm instrumenta të tërthorta për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | studimit. Referuar RVB, Tabela 24 , vlen të përmendet edhe Sondazhi Kombëtar i studentëve në kuadër të plotësimit të pyetësorëve. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

| | |
|---|---|
| Standardi VI.4 | |
| Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | Referuar RVB, IAL ka parashikuar në Statut (evidenca A), Rregullore (evidenca C), Planin Strategjik 2018-2024 (evidenca B), përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Përsa më sipër, GVJ konstaton se në Statut, Rregullore dhe Planin Strategjik, IAL ka përcaktuar rolin dhe detyrat konkrete për njësitë, studentët dhe palë të tjera të përfshira për sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. |
| Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | GVJ vëren gjithashtu, se një nga politikat e institucionit për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë konsiston në zhvillimin në mënyrë vazhdueshme të pyetësorëve nga ana e studentëve (Tabela 24 në RVB). |
| Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit. | GVJ konstaton se në nenin 22 të Statutit të IAL (evidenca A) është parashikuar ngritja në nivel Fakulteti e Komisioneve të Sigurimit të Cilësisë Brendshme. Në këto komisione është parashikuar, gjithashtu edhe pjesëmarrja e studentëve përveç trupës mësimore. <i>GVJ vëren se këto komisione nuk janë krijuar siç edhe deklarohet në RVB. GVJ shpreh mendimin se krijimi i komisioneve është i nevojshëm për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit.</i> |
| Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | Në zbatim të ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, GVJ konstaton se IAL ka respektuar lirinë dhe etikën akademike gjatë vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet strukturave përkatëse (evidencat A dhe C). Gjithashtu, GVJ vëren (referuar takimeve “online”) se gjatë plotësimit të pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit e realizuar nga studentët e çdo kursi është ruajtur anonimiteti dhe konfidencialiteti i tyre (evidencat L, K dhe IV.6). Nuk raportohet të ketë patur raste që studentët apo pedagogët të ankohen për shfaqje të diskriminimit apo pabarazisë. <i>GVJ konstaton se Evidenca, 641, Publikimi i Analizës së pyetësorëve në website-in e UV: <a 136="" 423="" 876="" 891"="" data-label="Page-Footer" href="https://univlora.edu.al/2019/12/11/publikimi-i-</i></td> </tr> </table> </div> <div data-bbox=">Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë</i> |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>raportit-te-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve/ rezulton jo aktive në faqen zyrtare të IAL.</i> | | | |
| Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | Në kuadër të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe përfshirjen në këtë vlerësim edhe të bashkëpunëtorëve dhe/ose ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit, IAL ka organizuar workshop-e të ndryshme. GVJ konstaton, organizimin e Workshop-it me temë “ <i>Studentët dhe tregu i punës</i> ” (evidenca II.6). Aktiviteti u zhvillua me pjesëmarrjen e autoriteteve drejtuese të IAL-së dhe drejtues/përfaqësues të Institucioneve Publike e Private. Në fund të Workshopit drejtuesit dhe përfaqësuesit e Institucioneve Publike e Private propozuan rekomandimet për përmirësimin e programeve të studimit. Workshop është pasqyruar edhe në faqen zyrtare të UV. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | GVJ vlerëson se IAL nëpërmjet faqes zyrtare, www.univloria.edu.al, pasqyron në mënyrë transparente dhe bën publike politikën, strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë për studentët dhe të gjithë të interesuarit. Përsa më sipër, publikimi dhe transparenca realizohen në kuadër të të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit. |
| Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | GVJ vëren se IAL/DK ka përpiluar Raportin e Analizës së Pyetësorëve të Studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për çdo Lëndë të Programit të Studimit të cilin e ka raportuar edhe në Standardin VI.5, Kriteri.2. Hartimi i Raportit të Analizës është në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.531, datë 11.09.2018, “Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”. Raporti është publikuar në nivel Njësie Kryesore dhe përmban raportin përkatës edhe të DK. Informacioni i publikuar respekton lirinë dhe etikën akademike konform Ligjit Nr.9887 datë 10.03.20008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. |
| Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | Referuar RVB, GVJ konstaton se krahas të Raportit të Analizës, IAL/DK përpilon edhe projekt propozimet si dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë. Këto propozime përcillen në strukturat përkatëse dhe zbatimi i tyre monitorohet nga NJSBCVI. <i>GVJ vëren gjithashtu, se përgjatë raportit përmendet zhvillimi i pyetësorëve për dy vite akademike radhazi. Evidenca III.11: Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet rezultateve të anketimit për DK, viti akademik 2017-2018, paraqet analizën vjetore</i> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>vetëm për një vit akademik. GVJ shpreh mendimin sikundër anketimet duhet të jenë të përvitshme edhe Raporti i Analizës dhe rekomandimet përkatëse duhet të jenë të përvitshme.</i> | | | |
| Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | Bazuar në RVB, GVJ vlerëson, se në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të instrumentave të vlerësimit të cilësisë të Programeve të Studimit, IAL ka përfshirë në planin e masave ngritjen e grupit të punës, në nivel institucioni. Procedura është vënë në zbatim me Urdhër të Rektorit Nr. 123 datë 19.12.2019645 (evidenca V.17). | | | |
| Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | Bazuar në evidencat mbështetëse të RVB, GVJ vëren se IAL organizon takime periodike me personelin dhe studentët për t'i informuar në lidhje me sigurimin dhe përmirësimin të cilësisë së programit të studimit ⁸ . Këtu mund të përmendet plotësimi i pyetësorëve dhe pjesëmarrja në Sondazhin Kombëtar të Studentëve, publikimi i njoftimeve në llogaritë personale në UVMS etj. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|--|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

⁸Aktiviteti "Rëndësia e përfshirjes së studentëve në politikat e vlerësimit të UV"

<https://univlora.edu.al/aktivitete/>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Kimi” në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi Bachelor në “Kimi” i Departamentit Kimi ka një veprimtari prej 10 (dhjetë) vitesh akademike dhe është i mirëorganizuar dhe i konsoliduar.
2. Për shkak të ngjashmërisë me programe të tjera programi ofron mundësinë e transferimit të studentëve nga një institucion në tjetrin për zhvillimin nga ana e tyre të programit të studimit të ciklit të dytë, Master Shkencor në AML (mësuesi).
3. Programi kryen vlerësimin e cilësisë së programit të studimit dhe cilësisë së mësimdhënies dhe bashkëpunon me IAL brenda dhe jashtë vendit (marrëveshjet institucionale me universitetet e huaja) për rritjen e cilësisë së programit dhe zhvillimin e kërkimit shkencor.
4. Departamenti i Kimisë është angazhuar në projekte ndërkombëtare dhe i vë ato në funksion të rritjes së cilësisë së programit dhe rritjes së mundësive të mobiliteteve për studentët dhe stafin akademik.

Pika të dobta:

1. Studimi i tregut të punës nuk rezulton i plotë. Megjithëse rezultojnë të dhëna nga vetë Departamenti i Kimisë se studentët e diplomuar aty janë punësuar në sektorët publikë (35 % e rasteve) dhe privat (40 % e rasteve) nuk është paraqitur një raport i plotë i studimit të tregut të punës. Nuk rezulton të ketë asnjë evidencë mbështetëse në lidhje me pyetësin e realizuar. Mungon “database” i të dhënave (numri i studentëve që kanë marrë pjesë, lista e emrave, viti i diplomimit etj.)
2. Departamenti i Kimisë/Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore nuk ka ngritur komisionet apo njësitë të sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel fakulteti (ngritja e tyre është gjithësi parashikuar). Ngritja e këtyre komisioneve ose hartimi i një Manuali të Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik është i nevojshëm për përshkrimin e të gjitha procedurave, shkallët dhe elementët e vlerësimit të performancës së stafit akademik e cila mund të përdoret më tej edhe për përmisimin e cilësisë së programeve.

3. Megjithëse programi i studimit i ofruar nga Departamenti i Kimisë plotëson kushtin e ngjashmërisë me programet e tjera deri në nivelin 70%, lëndët Kimi Fizike I dhe Kimi Fizike II kanë mungesa të tematikave të punëve laboratorike (të formimit karakterizues) si dhe të pajisjeve didaktike përkatëse.

Rekomandime:

1. Departamenti i Kimisë duhet të realizojë një studim të plotë të tregut të punës i cili mund të përbëjë një bazë për përcaktimin e kuotave të pranimit për këtë program studimi.
2. Të realizohet ngritja e komisionit sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel fakulteti ose të hartohet Manuali i Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik.
3. Rekomandohet të rritet numri i PAE të kategorisë “Profesor”.
4. Shumica e lëndëve karakterizohet nga 8 (tetë) kredite, që përfaqëson një numër të lartë krahasuar me lëndët e njëjta/ngjashme në universitete të tjera. Në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies rekomandohet rritja e numrit të lëndëve që ofrohen dhe ulja e krediteve respektive për to.
5. Departamenti i Kimisë, duhet të kryejë vlerësime dhe analiza të përvitshme të cilësisë së programeve.

Conclusions of the study program evaluation of the first cycle Bachelor in “Chemistry” at the University “Ismail Qemali”, Vlora

Strengths and affirmations:



1. The Bachelor program in “Chemistry” of the Chemistry Department has an activity of 10 (ten) academic years. Therefore, it is well organized and consolidated.
2. Due to the similarity with other programs, the Bachelor program in “Chemistry” of the Chemistry Department offers the possibility of transferring students from one institution to another. Thus, it allows the students to carry out the second cycle of the program (Master’s program) at other HEIs.
3. The program conducts evaluation of the study program and assessment of staff performance and skills. It cooperates with HEIs inside and outside the country (institutional agreements with foreign universities) and uses it to review the study program and develop scientific research.
4. The Chemistry Department is engaged in international projects and puts them in function of increasing the quality of the study program and possibilities to the mobilities of students and staff.

Weaknesses:

1. The market research is not complete. Although, there is data indicating that 35% of the graduate students are employed in the public sector and 40% of the graduate students are employed in the private sector, there is no full report of the market research. Additionally, there is no supporting evidence regarding the completed questionnaire’s (the database of the questionnaire’s is absent).
2. The Department of Chemistry within The Faculty of Technical and Natural Sciences has not set up yet the commission of internal quality unit at the faculty level (its establishment is foreseen anyway). The establishment of such a commission or the drafting of Academic Staff Performance Evaluation Manual is necessary to define all the procedures and elements of academic staff performance and skills. The latter can be further used for the review of the study program.
3. Although, the study program offered by the Chemistry Department meets the similarity criterion with other programs up to 70%, the subjects of Physical Chemistry I and Physical Chemistry II have lack of laboratory topics and respective didactic equipment’s.

Recommendations:

1. The Chemistry Department should complete the market research. The latter can determine the admission quotas for the study program.
2. To set up the establishment for the commission of internal quality unit at the faculty level or to draft the Academic Staff Performance Evaluation Manual.
3. It is recommended that the Chemistry Department should increase the number of EAS (Effective Academic Staff), "Professor" category.
4. Most of the subjects have 8 (eight) credits (ECTS) which represent a high number compared to the same subjects of similar programs at other HEIs. In order to increase the quality of teaching and learning, the Chemistry Department should increase the number of subjects offered by the program by reducing the credits number of the existing ones.
5. The Chemistry Department should conduct annual evaluation and analyses of the program quality.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|--|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | X | |
| II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | X | |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE | | | X | |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | X | |

